

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7855 E enjte 18 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Damjet apokaliptike të flakëve në katedralen më të famshme në të gjithë botën janë ende të freskëta. Ashtu si apokalipsi i Kullave Binjake në Nju Jork, ...
Vijon në faqen 20

Nga RICK FULKER
Notre-Dame do të ringrihet


Opinion Ditës
Të shumta në historinë moderne, dhe po aq të përbindshme, janë rastet e mohimeve të krimeve të luftës, vrasjeve, masakrave, dhunimeve, plaçkitjeve. ...
Vijon në faqen 21

Nga ARBEN IDRIZI
Mohuesit e krimeve




Grabitësit përdorën "crash doors"
Hetimi për grabitjen e Rinasit, dyshimi për 3 grupe kriminale. Ja dëshmitë e reja

Policia, letër kompanive të fluturimit: Vendosni kamera në barkun e avionit
TIRANË-Policia ka zbuluar gjurmë gishtash në furgonin që u përdor nga grabitësit në Rinas. Prokurorët besojnë se ekzaminimi i gjurmëve mund të çojë në identifikimin e autorëve të tjerë. Sipas burimeve të TV "Klan", përgjigjja e laboratorit të policisë shkencore pritet të vijë brenda kësaj jave. Shtatë ditë pas grabitjes së 6.5 milionë eurove në pistën e aeroportit...
Në faqen 9

NDERTIMI I BULEVARDIT TE RI, VELIAJ: POLITIKANET E OPOZITES, TE LLASTUAR SHEMBJET TE BREGU I LUMIT, PERPLASJE POLICI-BANORE

Orë tensioni, planifikohet prishja e 38 shtëpive. PD dhe LSI padisin Policinë e Shtetit dhe Bashkiaken. Basha: Nuk mbahet pushteti me dhunë



(Në foto) Forcat e Policisë së Rendit dhe asaj Bashkiake, dje gjatë prishjes së shtëpive në zonën e Bregut të Lumit Në faqen 2-3

'UNAZA E RE'
Vendimi, 10 milionë euro kompensim për pronarët e shtëpive të "Astiri"
Në faqen 10

VERIFIKIMET NE TERREN
Drejtori i Tatimeve: Informaliteti, do kontrollojmë 14 mijë bare dhe restorante
Në faqen 12

REKTORI I "LUARASIT"
Profesor Et'hem Ruka vlerësohet "Nderi i Labërisë": Ndiem krenar për kontributin
Në faqen 7

DIALOGU
Takimi në Berlin me Vuçiq, Thaçi: Nuk kemi asnjë axhendë të fshehtë
Në faqen 16

LEVIZJA E LIRE

Rikthimi i vizave, BE: S'ka kërkesë nga holandezët. PS: Faji i Bashës
Në faqen 4

Ambasadori Mircea Perpelea: Në këtë universitet njohëm pedagogë të shkëlqyer
Diplomatët rumunë te "Luarasi": Shembull për arsimin
Prof. Dr. Chiriac: Shkëmbim eksperiencash me rrjetin e vullnetarëve

Auditori i kolegjit universitar "Luarasi" mirëpriti dy personalitete të Rumaniisë në konferencën me titull "Rumania dhe vlerat europiane". Të ftuarit e nderit ambasadori i Rumaniisë Sh.T.Z. Mircea Perpelea dhe Prof. Univ. Dr. Constantin Chiriac dhanë idetë e tyre



mbi formimet europiane të vendeve të Ballkanit duke u nisur nga vetë vendi i tyre. U diskutua mbi rrugën që duhet të ndiqet për të qenë pjesë e Bashkimit Europian e gjithashtu, mbi vlerat humane që përkrah duhet të ketë e të ofrojë për të qenë qytetar i botës ...
Në faqen 7

BULEVARDI PËRPLASJA

Tensionet te Bregu i Lumit, opozita: Terror edhe mbi gratë dhe fëmijët

Valentina Madani

Dhuna mbi banorët, PD padit Policinë e Shtetit dhe atë Bashkiake

LSI, kallëzim për shefin e komisarariatit nr.4: Dhunoi gra të pafajshme

PD-ja dhe LSI-ja bënë dje padi ndaj Policisë së Shtetit dhe LSI-së për dhunën e ushtruar mbi banorët e zonës së Bregut të Lumit. Ish-deputetja, Jorida Tabaku njoftoi se PD-ja ka dorëzuar në prokurori kallëzimin penal dhe kërkon marrjen e masave për sjelljen brutale, joligjore e johumane gjatë të gjithë periudhës kohore të gjashtë muajve të fundit, por veçanërisht gjatë mëngjesit të 9 prillit ku fëmijë, gra e të moshuar u dhunuan barbarisht në gjumë nga shteti që duhet t'i mbrojë. "Një i moshuar 76-vjeçar u operua në kokë, dy zonja me gjymtyrë të thyera, gra e vajza në komisarariat e një fëmijë vetëm 5 vjeç përfundoi me komisarariat. Kjo sjellje kriminale e policisë duhet të marrë menjëherë përgjigje ligjore dhe urdhëruesit nga Kryetari i Bashkisë, Ministri i Brendshëm deri te kryeministri duhet të vihen para drejtësisë. Këto sjellje prej banditësh të policisë që dhunen e ka për qytetarët dhe jo për krimin duhet të marrin fund njëherë e përgjithmonë bashkë me bandën në pushtet. Sa kohë që të vazhdojnë për aq kohë qytetarët jo vetëm nuk do të jenë të mbrojtur, por do të gjenden nën dhunën e shtetit policor, siç ndodhi sërish. Shteti si hajdut shkoi në të gjithë dhunoi gra e fëmijë, largoi median e zaptoi banesat. Kjo sjellje duhet të marrë fund. Kjo sjellje prej pushtesit e arroganti ndaj të dobëtëve e të pambrojturëve duhet të përfundojë. Kam bindjen që ky kallëzim do të flejë ashtu si flenë dosjet e korrupsionit e dosjet e krim-it, ashtu si fshihen përgjimet e vjedhjes së zgjedhjeve e ashtu si fshihen sa e sa krime. Por e sigurte është që drejtësia vonon, por nuk harron! Do të vijë dita kur këto shkelës ligji të vihen para drejtësisë", - shprehet Tabaku.




Faksimile e padisë së PD-së, për Policinë e Shtetit dhe atë Bashkiake

DENONCIMI
Partia Demokratike denoncoi dje se policia ka ushtruar dhunë mbi banorët te Bregu i Lumit. Sipas PD, kjo është një tjetër provë që policia ka ushtruar dhunë ndaj banorëve, si edhe ish-deputetëve që kanë dalë krah tyre. Në vendngjarje kanë shkuar sërish fadromat e IMT-së që kanë për objektv prishjen e shtëpive të banorëve të zonës, e sipas PD-së ka pasur edhe përplasje mes tyre dhe policisë.



Dje te Bregu i Lumit



Strategjia, Basha takon Kryemadhin, sot mbledh Këshillin Kombëtar

Kreu i PD-së: Nuk mbahet më pushteti me dhunë

Përplasia, Basha: Fund dhunimit të Shqipërisë nga një grup banditësh



parë edhe qytetarët dhe përfaqësuesit e opozitës në mbështetje të banorëve të dëbuar, janë fytyra e vërtetë e Edi Ramës. Dhunuesit i zonjës tek Bregu i Lumit është shefi i komisarariatit 4, Agim Hoxha, një bandit me uniformë, që ka dhunuar më

THIRRJA
"Të qëndrojmë të bashkuar dhe të vendosur për t'i dhënë fund dhunimit të Shqipërisë nga një grup banditësh me pushtet të vjedhur e të blerë me krimin. Së bashku do të bëjmë të mundur që dhunuesit e shqiptarëve, nga Rama deri tek banditët me uniformë, të japin llogari para ligjit për çdo padrejtësi", - tha z.Basha.

bahçes për të mbajtur frymën gjallë si dhe shumë qytetarë të pambrojtur. Edi Rama nuk mund ta mbajë më pushtetin e tij të paligjshëm veçse duke përdorur dhunën: dhunë kundër qytetarëve, dhunë

kundër gazetarëve, dhunë kundër kundërshtarëve politikë, dhunë kundër Kushtetutës. Dhunë ndaj kujtdo që i tregon ligjin Edi Ramës, qoftë ky artist që mbron teatrin, qytetar që mbron shtëpinë apo opozitar që mbron të drejtat e qytetarëve. Thirrja ime për çdo shqiptar është të qëndrojmë në këmbë! Të qëndrojmë të bashkuar dhe të vendosur për t'i dhënë fund dhunimit të Shqipërisë nga një grup banditësh me pushtet të vjedhur e të blerë me krimin. Së bashku do të bëjmë të mundur që dhunuesit e shqiptarëve, nga Edi Rama deri tek banditët me uniformë, të japin llogari para ligjit për çdo padrejtësi", - deklaroi z. Basha.

PADIA
Më herët LSI kallëzoi penalisht edhe kreun e komisarariatit nr.4 Agim Hoxha për dhunën ndaj një gruaje te Bregu i Lumit. Ish-deputetja e LSI-së Silva Caka publikoi para mediave disa pamje që tregonin sipas saj, dhunën shtazarake dhe të pashembull të qeverisë të ushtruar te Bregu i Lumit. Pas denoncimit të Cakës, LSI e konkretizoi propozimin e saj duke kallëzuar penalisht drejtuesin e komisarariatit nr.4 z. Agim Hoxha në Prokurorinë e Tiranës. "Te Bregu i Lumit, gra të thjeshta dhe punëtore të cilat luftojnë çdo ditë me varfërinë, nga që

luftojnë në mënyrë të përditshme për mbijetesë, gra që luftojnë me papunësinë, u përballën me dhunën e shfrenuar të një policie që nuk ka më objekt luftën ndaj krimineleve, por tashmë objekt të saj ka luftën ndaj qytetarëve të thjeshtë", deklaroi Caka. Ajo tha më

tej se këto gra po mbronin sot banesat e tyre nga grabitja dhe hajdutëria qeveritare në mënyrë që fëmijët e tyre të kishin një strehë ku të fusin kokën dhe denoncoi kreun e komisarariatit 4 në Tiranë. "Këto gra po mbronin gjakun dhe djersën e tyre të hedhur në ato shtëpi

pi. Ushtruesit e dhunës e kanë një emër. Një prej tyre është pikërisht Agim Hoxha, kre i komisarariatit nr. 4 edhe eprorët e tij që kanë urdhëruar këtë dhunë të pashembullit e kanë një emër. Duke filluar nga Sander Lleshaj, kryeministri dhe gjithë të tjerët, të

gjithë këta do përballen me ligjin dhe askush të mos shpresojë që do t'i shpëtojë padisë penale të drejtuar prokurorisë së Tiranës. As qeveria dhe as drejtësia e kapur nuk do të mundin t'i shpëtojnë dot përgjegjësit e asaj dhune të ushtruar te Bregu i Lumit", - tha Caka.



Policja Blerta Dervishi, krah kolegëve te Bregu i Lumit

Përplasje me policinë për të kundërshtuar shembjen e banesës, skenari duket i njëjtë, por për efektiven Blerta Dervishi, situatat janë të ndryshme. Pamjet e pak kohëve më parë, ndërsa punonjësja e policisë Blerta Dervishi përplasje me kolegë të saj policë duke kundërshtuar shembjen e banesës së saj bënë xhiron e mediave apo rrjeteve sociale, ndërsa sot situata është krejt tjetër. Blerta Dervishit, këtë herë nën uniformën e policisë, i është dashur të përballlet me banorë të Bregut të Lumit, të cilët, ashtu sikundër vetë ajo pak kohë më parë, sot kundërshtojnë të dalin nga banesat e tyre. Bler-



ta Dervishi, është rreshtuar krah kolegëve të saj, duke mbrojtur rendin në zonën e Bregut të Lumit e duke mos lejuar banorët të hyjnë në banesat e tyre, të parashikuara për të shembur, pasi preken nga projekti i Bulevardit të Ri.

Dhuna ndaj Balliut e Braimallarit, Veliaj: Politikanë të llastuar

Bregu i Lumit, policët kapin nga fyti banorë dhe deputetë

Dorjana Bezat

Me tension, të bërtit ura, deri konflikt fizik mes policisë e banorëve, është shoqëruar shembja e shtëpive te Bregu i Lumit që do t'i lërë vend, ndërtimit të bulevardit të ri. Në këtë segment rrugor do të shemben 38 shtëpi ndërsa deri më tani janë prishur vetëm 10. Banorët thonë se nuk janë kundra ndërtimit të bulevardit, por duan dëmshpërbim për shtëpitë e tyre, ndërsa problemi është që këto shtëpi nuk janë të legalizuara çka do të thotë që pronarët s'mund të përfitojnë asgjë. Aksioni i Ndërtimores u shoqërua nga forca të shumta policie, të cilët largonin banorët për të mos penguar ndërhyrjen. Sipas banorëve, policia iu ka mbledhur telefonat me qëllim që ata të mos filmojnë aksionin për prishjen e shtëpive të tyre. Aksioni nisi në orët e para të mëngjesit të së mërkurës, ku janë raportuar edhe konfrontime fizike. Ndërkaq as mediat dhe gazetarët nuk u lejuan të afrohen për të filmuar shembjen e shtëpive.

DHUNA

Një banor i zonës, i cili tentoi të çante kordonin e policisë ka shkakuar tension te Bregu i Lumit në Tiranë. Dy ish-deputetë e opozitës, Klevis Balliu dhe Endrit Braimallari janë konfrontuar fizikisht me forcat e policisë në përpjekje për të ndihmuar qytetarin

Peposhi: Dua të nxjerr rrobat nga shtëpia, s'më lënë



Ish-deputetët e opozitës, Balliu dhe Braimllari gjatë përplasjes me policinë

Përplasja mes banorëve dhe policisë, djete Bregu i Lumit



TENSIONI

Aksioni nisi në orët e para të mëngjesit të së mërkurës, ku janë raportuar edhe konfrontime fizike. Ndërkaq, as mediat dhe gazetarët nuk u lejuan të afrohen për të filmuar shembjen e shtëpive.

Agim Peposhi. Ky i fundit pretendoi se nuk ka patur mundësi t'i largonte pajisjet e shtëpisë teksa u shoqërua në orët e para të kësaj të mërkure në komisariatit e policisë. Në foto duket qartë

momenti kur efektivi i policisë kap për fyti ish-deputetin e Partisë Demokratike, Klevis Balliun, ndërsa për asnjë çast nuk kanë mundur shtyrjet nga të dyja palët. Përpjekja e të riut, por

edhe e dy ish-deputetëve të opozitës rezultoi e kotë pasi kordonin i policisë mbeti i pacenuar. Ndryshe nga java e kaluar policët nuk kanë përdorur gaz lotsjellës kundrejt banorëve.

BASHKIA

Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj ka reaguar pas përplasjes së ish-deputetëve të opozitës me policinë tek Bregu i Lumit, ku do të ndërtohet pjesa e fundit të Bulevardit të Ri. Duke folur në konferencën "Smart City Solution", Veliaj deklaroi se politikanë të llastuar dhe të fortë të politikës shqiptarë nuk mund të bllokojnë ndryshimin. "Ju e dini fare mirë, ky është një qytet që ka vështirësitë e veta. Teksa flasim, po ecim me punimet për tek piazza e fundit e Bulevardit të Ri, por ka ende fëmijë tevegël e të llastuar politikaneësh dhe të fortësh të politikës shqiptare, që i bëjnë rezistencë ndryshimit, por ndryshimi do vijë. Është i paevitueshëm. Në mos do e sjellim ne, do e sjellë dikush që vjen pas nesh. Po më mirë ta sjellim ne që e kemi në dorë, sesa t'ia lëmë gjithmonë si gjobë një generate tjetër", tha Veliaj.

RIKTHIMI I VIZAVE REAGIMET

Valentina Madani

Qeveria holandeze nuk parashikon ta paraqesë në Bruksel mocionin e parlamentit për aktivizimin e mekanizmit të pezullimit të regjimit të lirë të vizave për qytetarët shqiptarë. Kjo ishte përgjigjja e ministrit të Jashtëm, Stef Blok për ligjvënësitet e ekstremit të djathtë që kërkuar rivendosjen e vizave për shqiptarët. Ministri i Jashtëm holandez Stef Blok thuhet se u tha ligjvënësve para votimit se ai nuk po planifikonte të bindë Brukselin për të risjellë vizat për shqiptarët. Sipas njoftimeve të medias, masa për rikthimin e vizave ishin motivuar nga veprimtaria e grupeve kriminale të lidhura me Shqipërinë. Shqiptarët kanë qenë në gjendje të udhëtojnë në Bashkimin Evropian pa viza që nga dhjetori 2010. Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE në 2009 dhe mori statusin e kandidatit në 2014.

REGIMI

Për mocionin e parlamentit holandez është në dijeni dhe Komisioni i BE-së, por zëdhënësja, Natasha Bertaud tha se deri tani asnjë vend nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për aktivizimin e mekanizmit të pezullimit të vizave. "Komisioni është në dijeni të mocionit të kaluar në parlamentin holandez të martën, por për aktivizimin e mekanizmit të pezullimit të vizave ka një procedurë të caktuar dhe deri tani ne nuk kemi asnjë njoftim nga ndonjë vend anëtar", tha Bertaud. Zëdhënësja shtoi se Shqipëria vijon të përmbushë kushtet për përfutimin e liberalizimit të vizave. Të martën Dhoma e Ulët e parlamentit holandez votoi mocionin për shkak të shqetësimit nga grupet kriminale me prejardhje shqiptare dhe migracionit të paligjshëm. Por sipas Ministrisë shqiptare për Europën dhe Punët e Jashtme migracioni i paligjshëm i shqiptarëve drejt Holandës ka rënë vazhdimisht. Ndërsa sipas qeverisë së holandeze në vitin 2016 ishin 710 shqiptarë të dyshuar që kanë hyrë ilegalisht në vend. Në vitin 2017 499 dhe në vitin 2018 janë 476. Shqipëria përfitoi liberalizimin e vizave në vitin 2010, ndërsa në vitin 2014 mori statusin e vendit kandidat.

DEKLARATA

Ambasadori i Bashkimit Europian në Tiranë, Luigi Soreca sheh kundërtënie në vendimin e parlamentit të Holandës për pezullimin e vizave në Bruksel kërkesën për rikthimin e vizave me Shqipërinë. Ai shprehet se pre-

Qeveria holandeze, kundër parlamentit për kthimin e vizave për shqiptarët

Rikthimi i vizave, Brukseli: Asnjë kërkesë nga Holanda për pezullim

BE: Shqiptarët do të lëvizin pa viza në Shengen

tendimet e paraqitura në mocionin mbi rritjen e kriminalitetit nga shqiptarët duhet të faktohen. "Tani për tani Komisioni do të bëjë

vlerësimin e vet. Vetë qeveria holandeze në debatin që patën në parlament nuk është shprehur që ka një lidhje të qartë ndërmjet udhëtimit

pa viza dhe krimit të organizuar. Prandaj do të nevojiten të dhëna dhe statistika që të arrihet kjo lidhje që nuk është vërtetu-

ar ende", deklaroi z.Soreca. Ambasadori sjell në vëmendje skanimin që Brukseli i bëri 4 muaj më parë respektimit të kriterëve nga vendet e zonës Schengen, ku Shqipëria rezultoi se përmbushte të gjitha kriteret. I pyetur nëse vendimi i parlamentit të Holandës do të ndikojë në çështjen e negociatave, Soreca tha se vendimi i qershorit do të bazohet në raport-progresin e majit. "Vendimi që u mor në parlamentin holandez dhe që do shikojmë nëse do jetë qeveria holandeze që do t'i kërkojë Komisionit Europian. Ndërkohë që ka një raport tjetër që do të shikohet në lidhje me çeljen e negociatave që do të ndodhë në qershor", deklaroi ambasadori i BE-së në Tiranë. Si eurodeputeti që në 2010 udhëhoqi procesin e liberalizimit të vizave me Shqipërinë, Soreca tha se lëvizja e lirë është një arritje e madhe e shqiptarëve dhe se qeveria duhet të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje bashkëpunimit si me qeverinë e Holandës ashtu dhe me vendet e tjera.



Zëdhënësja e KE-së, Natasha Bertaud

KËRKESA

Zëdhënësja e Komisionit Europian, Natasha Bertaud tha: "Komisioni është i vetëdijshëm për mocionin që kaloi dje në parlamentin holandez, por ekziston një procedurë specifike që është për mekanizmin e pezullimit të vizave dhe deri më sot nuk kemi marrë asnjë njoftim nga asnjë shtet anëtar që kërkon një gjë të tillë".

VENDIMI

"Vendimi që u mor në parlamentin holandez dhe që do shikojmë nëse do jetë qeveria holandeze që do t'i kërkojë Komisionit Europian. Ndërkohë që ka një raport tjetër që do të shikohet në lidhje me çeljen e negociatave që do të ndodhë në qershor", deklaroi ambasadori i BE-së në Tiranë.

"Kthimi i vizave? Mocioni i Holandës, i pajustificuar"

Italia: Qeveria të punojë fort, të mos relaksohet në rrugën e reformave

Ambasadori Italian në Tiranë Alberto Cuttillo deklaroi dje se mocioni i parlamentit holandez për rikthimin e vizave nuk është një masë e justifikuar nga motivi që është ngritur, megjithatë çdo vend ka të drejtën të ketë një opinion ndryshe. "Sipas meje nuk është një masë e justifikuar nga motivi që është ngritur, por çdo vend ka të drejtën të ketë një opinion ndryshe e do të jetë komisioni më pas që do t'u përgjigjet këtyre kërkesave. Po flasim për një vend anëtar të BE, pjesë e vendeve të ulëta si Holanda e nuk di se farë e ka shtyrë politikën e saj të marrë një vendim të tillë e për këtë



duhet të pyesni ambasadorin e Holandës në Shqipëri", tha z.Cuttillo. Ambasadori beson se Shqipëria meriton hapjen e negociatave, por shtoi se kjo nuk do të thotë që ajo mund të relaksohet. "Këshilla që unë i jap


qeverisë shqiptare është ajo që jap gjithmonë, të punojë fort, të mos presë rezultate të garantuara, integrimi evropian është drejtimi i duhur për Shqipërinë, Shqipëria meriton hapjen e negociatave të hyrjes në BE, por kjo nuk do të thotë se mund të relaksohet, ajo duhet të vazhdojë me rrugën e reformave. Nëse të gjitha forcat politike bashkëpunojnë këto reforma janë më efektive, vijmë më mirë e prandaj i ftoj të gjithë të bashkëpunojnë", deklaroi z.Cuttillo. Pyetjes se nëse ka ndryshuar dicka nga apeli i fundit. Cuttillo u përgjigj: "Nuk di e po ju pyes juve: A ju duket se ka ndryshuar dicka?"

BERISHA: LIDHJA E QEVERISË ME KRIMIN PO RIKTHEN VIZAT

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi se një nga arsytet se pse Holanda kërkon kthimin e vizave për Shqipërinë është lidhja e qeverisë me krimin. Në një postim në 'Facebook', Berisha shprehet se në Shqipëri, ministra dhe kriminelë inspektojnë dhe inaugurojnë së bashku. Këtu Berisha i referohet aksionit për mbylljen e gurore në Krujë, ku pas ministrit Klosi shfaqet Mond Voga, person në kërkim sipas Berishës. Voga së bashku me prokurorin Arjan Ndoj akuzohen për dhunimin e avokatit Ilija Ilija në Durrës, në korrik të vitit të shkuar. Prokurori akuzohet prej avokatit të dhunuar se ka futur Mond Vogën për ta dhunuar.



Parlamenti i Holandës



Kryemadhi: Kthimi i vizave dhe krimi mund të dëmtojnë negociatat

Kryetarja e LSI-së, Moni Kryemadhi akuzoi dje Kryeministrin Rama se po e mban me vetëdije vendin larg Europës, ndërkohë që për shqiptarët një gjë e tillë do të thotë izolim, mungesë punësimi dhe rritje mirëqenies. Për Kryemadhi, më shqetësuese sesa kërkesa e Holandës për rikthimin e vizave është arsyeja e këtij qëndrimi të parlamentit holandez. "Holanda është vetëm një nga vendet që e ka ngritur këtë çështje, por fatkeqësisht ky fenomen ka prekur edhe shumë vende të tjera të BE. Dua të kujtoj raportin e DASH, që e cilëson Shqipërinë si një bazë operacionale për organizatat e krimit të organizuar që operojnë në SHBA, Europë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Jugut. Ky fenomen i ngritur zyrtarisht nga Holanda rrezikon të marrë një efekt zinxhir në debatin e ardhshëm të vendeve anëtare mbi procesin e integritimit evropian dhe konkretisht për çeljen e negociatave që shqiptarët aspirojnë", theksoi zj.Kryemadhi. Sipas saj parlamenti holandez "konfirmoi plotësisht faktin se nuk janë protestat e opozitës apo dëgjia e mandateve arsytet e mosçeljes së negociatave, por kapja e shtetit, keqeverisja dhe kapja e të gjithë institucioneve nga krimi i organizuar".



BUSHATI

Për deputetët socialistë, vendimi i parlamentit holandez për rikthimin e regjimit të vizave për qytetarët shqiptarë është pjesë e një skenari të partive të caktuara ekstremiste dhe skeptike ndaj zgjerimit. Sipas tyre, argumentet ku u mbështet vendimi nuk qëndrojnë. Ish-ministri i Jashtëm, Dimitër Bushati, zgjodhi të mos komentojë për këtë temë.



Borchardt, takim me Ruçin: Qeveria dhe Kuvendi janë legjitimë

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, priti dje në një takim ambasadorin e OSBE-së në Tiranë, Bernd Borchardt. Sipas njoftimit të zyrës së shtypit të Kuvendit, kryeparlamentari Gramoz Ruçi dhe Kryetari i Prezençës së OSBE-së, Bernd Borchardt, biseduan edhe mbi situatën politike në Shqipëri, pas dorëheqjes së 57 deputetëve të opozitës. Bashkëbiseduesit ishin të një mendjeje se Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë janë plotësisht legjitimë, të dala nga zgjedhje të rregullta, të certifikuara nga vetë komisionerët e opozitës dhe raportet e OSBE-ODIHR dhe se e ardhmja e vendit dhe konsolidimi i sistemit demokratik kërkojnë që të gjitha forcat politike të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, ndërsa reforma zgjedhore konsensuale të përfundojë para zgjedhjeve të parlamentare të vitit 2021. "Qeveria e Republikës së Shqipërisë është plotësisht legjitime, e dalë nga zgjedhje të rregullta, e certifikuar nga vetë komisionerët e opozitës dhe raportet e OSBE-ODIHR dhe se e ardhmja e vendit dhe konsolidimi i sistemit demokratik kërkojnë që të gjitha forcat politike të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, ndërsa reforma zgjedhore konsensuale të përfundojë para zgjedhjeve të parlamentare të vitit 2021", - tha Borchardt. Në takim u bisedua mbi zgjerimin e bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Prezençës së OSBE-së. Bashkëpunimi i deritanishëm përfshin kontributin e Prezençës për fuqizimin dhe modernizimin e shërbimeve të Kuvendit, përmirësimin e infrastrukturës për shërbimin e deputetëve ndaj qytetarëve në territor, përmirësimin e rregullores dhe të procedurave të Kuvendit etj.

Cakaj u shpreh se vendimi i marrë nga parlamenti është i motivuar politikisht

Balla: Deputetja që propozoi vendimin për vizat, mikeshë e Bashës

"Basha lobon në Holandë për këtë"

Mazhoranca e majtë m pohon që vendimi i Parlamentit të Holandës për rikthimin e vizave për shqiptarët të ketë lidhje me situatën e kriminalitetit në Shqipëri apo me përkeqësimin e treguesve të rendit në vendin tonë. Sipas përfaqësuesve të së majtës qeverisë, ky vendim lidhet vetëm me debatin e brendshëm politik në Holandë dhe nuk do të ketë ndikim të prishëm të lëvizja e lirë e shqiptarëve në vendet e zonës së Shengenit.

CAKAJ

Ministri i Jashtëm, Gent Cakaj, i ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24" u shpreh se mocioni për vizat nga parlamenti holandez nuk është final. Ai u shpreh se ekziston një arbitër më i lartë, që vendos dhe ai është Komisioni Europian. "Vendimi i marrë nga parlamenti holandez është i motivuar politikisht. Kjo për shkak të zgjedhjeve në Holandë, ku ka parti me qasje përjashtuese ndaj vendeve që nuk janë anëtare të BE-së dhe ka rritje të populizimit të djathtë. Në këtë vendim të parlamentit holandez ndikon rritja e kërkesave për migracion, si dhe rritja e kërkesave për azil", - tha Cakaj. Gjithashtu, ai u shpreh se ky vendim ka të bëjë edhe me cenimin e sigurisë publike të vetë Holandës, e cila kërkon të kalojë përgjegjësitë të shqiptarët. "Faktor tjetër është edhe cenimi i sigurisë së publike të Holandës dhe shteteve të tjera në BE. Presim që Komisioni Europian të japë përgjigje negative ndaj vendimit të parlamentit holandez. Vendimi i marrë nga parlamenti holandez nuk duhet të cenojë për asnjë moment raportet me Holandës dhe Shqipërisë", - tha Cakaj. Gjithashtu, ministri Cakaj theksoi se nuk ka tërheqje të liberalizimit të vizave për shqiptarët dhe se pritet rekomandim pozitiv pa kushte për hapje të negociatave me Shqipërinë.

BALLA

Nga ana tjetër, kreu i grupit parlamentar i Partisë Socialiste, Taulant Balla, bëri të ditur se propozuesja e këtij vendimi në parlamentin holandez është një e njohur dhe mikeshë e kreut demokrat, Lulzim Basha. "Së pari, duhet të kuptojmë se Parlamenti i Holandës funksionon më ndryshe se tek ne, çdo deputet ka mendimin e tij. Deputetja që e propozoi rezolutën është mike e ngushtë e Lulzim Bashës. Populistët po përdorin çdo mjet që të denigrojnë kombin shqiptar. Nuk janë shqiptarët grupi problematik i krimimit në Holandë. Kriminaliteti i shqiptarëve që jetojnë në Holandë është 20 herë



Kreu i grupit parlamentar i Partisë Socialiste, Taulant Balla

REAGIMI

"Ajo që e bën shqetësuese është reagimi i turpshëm politik që ndodh në Shqipëri. Frenat e dorës nga BE-ja për regjimin e vizave ngrihen vetëm kur ka azilkërkuar, ky ka rënë. Por, së bashku me këtë ka rënë edhe kriminaliteti. Reagimi zyrtar i Holandës qetësoi shpirtat e trazuar".

Ish-ambasadori: Vendim i çuditshëm, duhet të punoni, të ndryshoni

Ish-ambasadori i OSBE-së në Tiranë dhe ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, si një njohës imirë realitetit shqiptar thotë se të gjithë në Shqipëri duhet të punojnë për të ndryshuar perceptimin që kanë holandezët për vendin tonë. Në një intervistë për "Top Channel", ai shpjegoi se vendimi për vizat është produkt i një çështjeje të brendshme e disa deputetëve për të treguar sesa ata janë kundër krimeve dhe sa të dëmshëm janë të huajt. "E kam ndjekur debatin në parlament gjatë mbrëmjes së të mërkurës. Mund t'ju them se jam i tronditur nga e gjitha kjo. Ishte një debat shumë i çuditshëm, nga ku ministri i vendit tim, që vizitoi pak kohë më parë vendin tuaj, prezantoi shumë fakte, por parlamenti dhe posaçërisht deputetja Toorenburg nuk i dëgjo, megjithëse ministri që vjen nga partia e saj tha se 'po, ekziston një problem me kriminalitetin shqiptar në Holandë, por ky është një problem i vogël. Diçka më pak se 0.2% të totalit të kri-



shëm, nga ku ministri i vendit tim, që vizitoi pak kohë më parë vendin tuaj, prezantoi shumë fakte, por parlamenti dhe posaçërisht deputetja Toorenburg nuk i dëgjo, megjithëse ministri që vjen nga partia e saj tha se 'po, ekziston një problem me kriminalitetin shqiptar në Holandë, por ky është një problem i vogël. Diçka më pak se 0.2% të totalit të kri-

meve e zënë shqiptarët'. Prandaj, e theksoj se ishte një debat shumë i çuditshëm, nga ku faktet e preantuar nuk luajtën asnjë rol, sikurse ajo çfarë tha ministri u injorua tërësisht dhe singerisht nuk ua them dot përse", - tha Bosch. Më tej, ai bëri të ditur se muajin e ardhshëm në Shqipëri do të jenë disa deputetë holandezë. "Ndaj theksoi ai - është e domosdoshme që politika shqiptare të punojë për t'i ndryshuar mendim. Gjithashtu, ai bëri të ditur se vetëm një ditë para votimit, gazeta më e madhe në Holandë bëri një artikull kundër shqiptarëve, çka duket se ndikoi në këtë vendimarrje.

dhe mikeshë e kreut demokrat, Lulzim Basha. "Së pari, duhet të kuptojmë se Parlamenti i Holandës funksionon më ndryshe se tek ne, çdo deputet ka mendimin e tij. Deputetja që e propozoi rezolutën është mike e ngushtë e Lulzim Bashës. Populistët po përdorin çdo mjet që të denigrojnë kombin shqiptar. Nuk janë shqiptarët grupi problematik i krimimit në Holandë. Kriminaliteti i shqiptarëve që jetojnë në Holandë është 20 herë

azilkërkuar, ky ka rënë. Por, së bashku me këtë ka rënë edhe kriminaliteti. Reagimi zyrtar i Holandës qetësoi shpirtat e trazuar. Ne kemi një bashkëpunim të shkëlqyer mes të dyja vendeve. Ajo që është për të ardhur keq, është reagimi antishqiptar nga politika në vend. Basha lobon në Holandë për këtë, por ky lobim nuk ka për ta dëmtuar Shqipërinë", - tha Balla, i cili theksoi se gjithsesi ky vendim nuk ka asnjë ndikim të vizat.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e tretë, për shitjen e pasurisë së palauajshme për të cilën ka vënë hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:
- Pasuria "ARE" nr. 175, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrësit, në pronësi të z.Adrjan Sefer Kapllani dit.08.03.1969, zj.Merita Myzafer Kapllani dit.24.06.1970
Në vlerën 7.308.000 (shtatë milion e treqind e tetë mijë) Lekë.
- Pasuria Apartamenti me sq. 120m2 nr.pas.41150+1 z.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh/13 Durrës në pronësi të z.Adrjan Sefer Kapllani dit.08.03.1969.
Në vlerën 3.390.569 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datën 20.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Palli, 21,Shk.3, Ap.18, Tiranë.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së palauajshme për të cilën ka vënë hipoteke ABI BANK, me këto të dhëna:
- "Are", me sipërfaqe 5.130 m², me adresë në Piraj, Lezhë, - në Zonën Kadastrale Nr. 2964, me Nr. Pasurie 201/9, Vol. 1, fq.127, në pronësi të znj. Alma Luji Marku.
Në vlerën 2.480.000 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.
- "Njësi", me sipërfaqe 191 m², me adresë në Lagjen "Besëlidhja", Lezhë, - në Regjistrin hipotekor Nr. 578, date 28.10.2016, në Zonën Kadastrale Nr. 8632, me Nr. Pasurie 4/400-N11, në pronësi të Shoqërisë ENCO-GROUP sh.p.k.
Në vlerën 107.200 EUR (njëqind e shtatë mijë e dyqind) EUR.
Ankandi zhvillohet në datën 03.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Palli, 21,Shk.3, Ap.18, Tiranë.

Konkurenti i Bashës në PD pranon mandatin, Kuvendi me 106 anëtarë

Një tjetër emër i njohur për demokratët ka pranuar të mos respektojë vendimin politik të partive opozitare dhe të pranojë mandatin e deputetit. Bëhet fjalë për Erion Picirin, i cili njihet si analist dhe për opinionin publik dhe në veçanti atë demokrat njihet edhe si rivali i Lulzim Bashës në zgjedhjet për kryetar të Partisë Demokratike. Kujtojmë që Piciri ishte kandidatë përballë Bashës, së bashku me Eduard Selamin. Ai ka dorëzuar formularin e dekriminalizimit dhe pritet që sot KQZ t'i

DEPUTETET E RINJ
Gjatë ditës së sotme KQZ pritet të japë edhe 3 mandate të tjera të kandidatëve që vijnë nga listat e PD dhe LSI. Më konkretisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e sotme pritet të japë mandatin e deputetit, kandidatit të listës shumëme të PD në Qarkun Gjirokastrë, Fatjon Koço, kandidatit të listës shumëme të PD, Qarku Korçë, Andi Përmeti. Po ashtu, KQZ do shqyrtojë të enjten dhe dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të listës shumëme të LSI-së, Eugen Bojaxhi, Qarku Berat.



Erion Piciri

japë mandatin e deputetit. Piciri ishte i 16 në listën shumëme të kandidatëve të PD-së në Qarkun e Tiranës. Ndërkohë që në një letër të hapur vetë Piciri shpjegonte dhe arsyet e këtij vendimi. "Këtë javë dorëzo-

va në KQZ formularin për të hyrë në parlament, jo për t'u bërë deputet apo për të legjitimuar një regjim antishqiptar, por për të çuar në Kuvend zërin e një Shqipërie që kërkon ndryshim të vërtetë", - shkruante ndër të

tjera Piciri në letrën e tij. Por gjatë ditës së sotme KQZ pritet të japë edhe 3 mandate të tjera të kandidatëve që vijnë nga listat e PD dhe LSI. Më konkretisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e sotme pritet të

japë mandatin e deputetit, kandidatit të listës shumëme të PD në Qarkun Gjirokastrë, Fatjon Koço, kandidatit të listës shumëme të PD, Qarku Korçë, Andi Përmeti. Po ashtu, KQZ do shqyrtojë të enjte

dhe dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të listës shumëme të LSI-së, Eugen Bojaxhi, Qarku Berat. Bashkë me kandidatët që pritet të marrin mandatin sot, numri i deputetëve në Kuvend shkon në 106.

Socialistët propozojnë në Kuvend ndryshimin e objektit të punës së komisionit

PS pranon diskutimin për sistemin zgjedhor, ja variantet në tavolinë

Katër janë variantet që po diskutohen për sistemin zgjedhor

Partia Socialiste ka bërë një hap pas nga qëndrimi saj për sistemin zgjedhor, teksa për hir të votës së deputetëve të rinj në Kuvend, por edhe mbështetjes së aleatëve, ka pranuar që të diskutojë për ndryshimin e tij. Bëhet fjalë për një qëndrim të shprehur tashmë edhe zyrtarisht nga Partia Socialiste, e cila ka paraqitur në Kuvend propozimin për ndryshimin e vendimit për Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, ku ndër të tjera kërkon që të përfshihet te objekti i diskutimeve edhe ndryshimi i sistemit zgjedhor. Kërkesa në Kuvend është paraqitur nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste Taulant Balla, dhe në vetvetë përmban disa propozime, ku më kryesorja ka të bëjë pikërisht me hapjen e diskutimit për sistemin zgjedhor. "Me qëllim realizimin e objektit të krijimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore dhe përfundimin e punës për miratimin e ndryshimeve të kuartit ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODHIR-it për tri zgjedhjet e fundit të viteve 2013, 2015 dhe 2017, si dhe propozimet e ndryshme të partive politike në vend propozoj kryerjen e disa ndryshimeve në këtë vendim. Pjesë e objektit të veprimtarisë të komisionit, të shtohet edhe çështja e sistemit zgjedhor në Shqipëri", - thuhet në letrën e Ballës. Kjo është hera e parë që PS pranon të hyjë në diskutime për një çështje kaq sensitive që nga momenti kur sistemi zgjedhor u ndryshua gati 10 vite më parë. Në tryezën e diskutimeve do jenë disa variante. I pari është ai për të korrigjuar sistemin aktual proporcional rajonal me lista të mbyllura në sistem proporcional rajonal me lista të hapura. Në rast se kjo do të realizohej atëherë do ishin zgjedhësit ata që do të përcaktonin se cilët nga listat që do paraqisnin par-



Komisioni i Reformës Zgjedhore

PROPORCIONAL-KOMBËTAR

Një variant tjetër që kërkohet nga partitë e vogla është ai për ta kthyer në një sistem proporcional kombëtar. Kjo do të favorizonte partitë e vogla, të cilat kështu do të rrisnin shanset për t'u futur në Kuvend. Por nga ana tjetër, kjo do të polarizonte shumë përbërjen e Kuvendit dhe do u krijonte mundësi forcave anonime që të mund të bëheshin pjesë e Kuvendit.

titë do të hynin në Kuvend. Por vetë kryeministri Edi Rama duke folur pak kohë më parë rreth këtij propozimi, theksoi se sistemi aktual me lista të mbyllura

bëri të mundur pastrimin e Kuvendit nga elementë kriminal, ndërsa mundësojë edhe një përfaqësim shumë të madh të deputeteve femra në Kuvend, çka sipas tij nuk do arrinte ta siguronte asnjë sistem tjetër zgjedhor. Një variant tjetër që kërkohet nga partitë e vogla është ai për ta kthyer në një sistem proporcional kombëtar. Kjo do të favorizonte partitë e vogla, të cilat kështu do të rrisnin shanset për t'u futur në Kuvend. Por nga ana tjetër kjo do të polarizonte shumë përbërjen e Kuvendit dhe do u krijonte mundësi forcave anonime që të mund të bëheshin pjesë e Kuvendit. Natyrisht që ky variant nuk i pëlqen dy forcave kryesore politike në vend. Një tjetër variant në diskutim është edhe kthimi i sistemit mazhoritar, ku partitë politike të konkurrojnë secila me kandidatët e tyre në çdo zonë zgjedhore. Natyrisht që edhe ky lloj sistemi ka të mirat dhe të këqijat e veta, kjo pasi përveçse e bën garën e ndershme mes kandidatëve më të mirë, shoqërohet me tensione të mëdha në ditën e votimit dhe numërim. Një tjetër variant në diskutim është edhe një sistemi që ka pasur vendi ynë, pra sistemi mazhoritar i korrektuar. Një variant edhe ky që solljo pak probleme për shumë vite në Shqipëri, ndërsa arriti të prodhojë edhe histori të tilla si ajo e "Dushkut" ku vetëm një zonë arriti të përcaktojë fatin e disa deputetëve.



PS kërkon shtyrjen e afatit të reformës deri në ditën e pavarësisë

Pjesë e kërkesës së Partisë Socialiste për të ndryshuar vendimin për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Reformës Zgjedhore, është edhe propozimi për të shtyrë sërish afatin e veprimtarisë së tij. Ndryshe nga sa u miratua dy javë më parë, socialistët kësaj here kërkojnë shtyrjen e afatit deri në 28 nëntorin e ardhshëm. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që ndryshimet zgjedhore do të miratohen të gjitha në nëntorin e ardhshëm. Kjo pasi sipas sekretarit për zgjedhore në PS, Damian Gjijnuri, komisioni do të punojë me faza, dhe në fazën e parë do të punojë për ndryshimet që do t'i shërbejnë zgjedhjeve të 30 qershorit. "Angazhim maksimal për të miratuar fazën e parë të ndryshimeve para zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. Pas tyre, dakordësi e plotë për të diskutuar mbi një paketë më të plotë përfshirë çështjen e sistemit zgjedhor. Opozitës parlamentare dhe asaj jashtë parlamentare u janë krijuar tashmë të drejta të plota e të barabarta në këtë komision", - shkroi Gjijnuri në faqen e tij në 'Facebook'.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të II (Dytë), për shtjetjen e pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 499386-3-N2, Vol. 52, Faza 239, ndodhur në Linëz Daj, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGLI" sh.p.k. identifikuar me NIPT J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 4,962,048 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyzet e çmimi) LEKË.

Ankandi do të zhvillohet më datë 23.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k., në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinh@hotmail.com.

UNIVERSITETI PRIVAT KONFERENCA

Prof. dok Chiriac: Shkëmbim eksperiencash me rrjetin më të madh të vullnetarëve

Diplomatët rumunë te 'Luarasi': Shembull i duhur për arsimin

Ambasadori: Në këtë universitet kam njohur pedagogë të shkëlqyer

TIRANE

Auditori i kolegjit universitar "Lu arasi" mirëpriti dy personalitete të Rumanisë në konferencën me titull "Rumania dhe vlerat europiane". Të ftuarit e nderit ambasadori i Rumanisë Sh. T. Z. Mircea Perpelea dhe Prof. Univ. Dr Constantin Chiriac dhanë idetë e tyre mbi formimet europiane të vendeve të Ballkanit duke u nisur nga vetë vendi i tyre. U diskutua mbi rrugën që duhet të ndiqet për të qenë pjesë e Bashkimit Europian e, gjithashtu, mbi vlerat humane që çdokush duhet të ketë e të ofrojë për të qenë qytetar i Botës.

I pyetur nga News24 ambasadori rumun dha idetë e tij sa i takon rrugës që Shqipëria duhet të ndjekë për të qenë pjesë e Bashkimit Europian dhe nëse vendi ynë duhet të ndjekë modelin rumun sa i takon reformës në drejtësi. "Unë nuk mendoj se ka një 'sekret' për rrugën që Shqipëria duhet të ndjekë për në Bashkimin Europian. Ajo çfarë Shqipëria duhet të bëjë është të punojë më shumë, të ketë rezultate të forta dhe të përpiqet maksimalisht në çdo fushë që të sjellë ndryshime. Ne si vend normalisht e mbështesim futjen e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe jemi krah tyre jo vetëm në bashkëpunimin politik, por edhe atë kulturor e, gjithashtu, në çdo fushë të mundshme, e cila sjell përparimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve dypalëshe. Lidhur me shembullin e Rumanisë, unë nuk mendoj që Shqipëria duhet të ndjekë një shembull ajo duhet ta bëjë vetë një shembull në lidhje me drejtësinë në vend. Pasi në fund nuk kanë të bëjnë shembujt e vendeve të tjera, por rezultatet. Nëse ka rezultate pozitive gjithçka shkon, siç duhet."

Ambasadori rumun nuk i kurseu konsideratat e tij për universitetin "Lu arasi": "Në universitetin Lu arasi ndihem gjithnjë mirë, pasi këtu kam njohur



Diplomatët rumunë te 'Luarasi'

"Ndhim krenar për kontributin modest që kam dhënë"

Et'hem Ruka, rektori i "Luarasit", "Nderi i Labërisë"

TEPELENE

Shoqata "Labëria" vlerëson vazhdimisht figurat patriotike e intelektuale, që kanë origjinin nga fshatrat dhe qytetet e saj.

Me titullin "Nderi i Labërisë" është vlerësuar këtë të mërkurë profesor Et'hem Ruka, rektori i universitetit "Lu arasi" në një ceremoni ku ishin të ftuar intelektualë, personalitete të fushave të ndryshme, ish-presidenti Moisiu, Kryegjyshi Botëror i Bektashizmit Dede Edmond Brahimaj etj. I ftuar ishte dhe zoti Irfan Hysenbelliu, Presidenti i Grupit Hysenbelliu, pjesë e të cilit është edhe universiteti "Lu arasi". Et'hem Ruka një nga personalitetet më të shquar nga Tepelena, shkencëtar, ish-ministër dhe një nga biologët më të shquar të vendit tonë. Është botues shkencor i mbi 140 librave, ndërsa sot drejton një nga universitetet private më të suksesshëm në vend. Vlerësimin ia dorëzoi mikui i tij, Namik Dokle.



"Dhuntinë që i ka dhënë natyra ai e ka shfrytëzuar në të mirë të popullit, në të mirë të Shqipërisë dhe të Labërisë, natyrisht. Është një njeri, i cili kurrë nuk ka ndaluar së punuari dhe në 27 vjet që e njoh Et'hemin sa herë i thosha: Çabën? - Shkruaj më thotë. Dhe në ato libra kanë mësuar breza të tërë, një pjesë prej tyre janë bërë edhe shkencëtarë, duke ndjekur rrugën e profesorit të tyre. Dhe kryevepra e Et'hemit është "Biologjia" - u shpreh Dokle.

"Ndhim shumë krenar që kjo krahinë më ka dhënë

gjithçka për një kontribut modest që kam dhënë në shërbim të Kombit. Është një gjë e jashtëzakontë. Është një jetë e shpenzuar në shërbim të Kombit në shërbim të brezave", - u shpreh Ruka.

Bashkë me z. Ruka, me të njëjtin çmim u nderuan, gjithashtu, edhe kreu i Bashkisë së Tepelenës, Tërmet Peci si edhe këngëtarja Ylli Baka. Pjesëmarrësit shijuan edhe një koncert me këngë nga grupet labe të Tepelenës, dhe recitime nga aktori i mirënjohur Bujar Asqeriu.

TE FTUARIT

Të ftuarit e nderit, ambasadori i Rumanisë Sh. T. Z. Mircea Perpelea dhe Prof. Univ. Dr Constantin Chiriac dhanë idetë e tyre mbi formimet europiane të vendeve të Ballkanit duke u nisur nga vetë vendi i tyre. U diskutua mbi rrugën që duhet të ndiqet për të qenë pjesë e Bashkimit Europian e gjithashtu, mbi vlerat humane që çdokush duhet të ketë e të ofrojë për të qenë qytetar i botës.

AMBASADORI

Ambasadori rumun dha idetë e tij sa i takon rrugës që Shqipëria duhet të ndjekë për të qenë pjesë e Bashkimit Europian dhe nëse vendi ynë duhet të ndjekë modelin rumun sa i takon reformës në drejtësi. "Unë nuk mendoj se ka një 'sekret' për rrugën që Shqipëria duhet të ndjekë për në Bashkimin Europian. Ajo çfarë Shqipëria duhet të bëjë është të punojë më shumë, të ketë rezultate të forta dhe të përpiqet maksimalisht në çdo fushë që të sjellë ndryshime."

pedagogë të shkëlqyer, mjaft të përgatitur që më bëjnë të ndihem mjaft mirë. Mendoj se do jem edhe herë të tjera për të biseduar me studentët për ekonominë dhe vlerat e Rumanisë, por jo vetëm. Gjithashtu, edhe për vlerat dypalëshe dhe komunikimin e dy vendeve për një ecuri më të mirë."

Si pjesë e kësaj konferencie prof. dok Chiriac shpjegoi programin e tij për të rinjtë dhe kulturat e dy vendeve nëpërmjet aktiviteteve kulturore, sociale dhe artistike që ai do të ndërmarrë duke filluar nga kjo konferencë e në ditët në vijim. Prof. Dok. Chiriac na jep edhe disa detaje mbi marrëveshjen e bërë midis tij dhe kolegjit universitar "Lu arasi" i cili do t'i hapë rrugë një bashkëpunimi afatgjatë midis dy vendeve. "Jam në Shqipëri, në universitetin "Lu arasi" si përfaqësues i një prej festivaleve më të rëndësishëm në Rumani dhe në Ballkan "Sibiu festival" i cili shihet në 75 qytete dhe përshin 7000 spektatorë çdo natë që e ndjekin. Dua që këtë festival ta sjell në Shqipëri dhe

të nisim kështu një marrëdhënie 3-vjeçare për të bashkuar në një festival të vetëm traditat dhe kulturën e Ballkanit e sidomos të dy vendeve tona Rumanisë dhe Shqipërisë. Konkretisht do jetë një bashkëpunim midis Teatrit Kombëtar, Akademisë së Arteve, Ministrisë së Kulturës dhe universiteteve duke filluar nga universiteti "Lu arasi".

Mendoj se fryma e të qenit një, që ekziston në Shqipëri, e këtu nisem nga fakti i bashkëjetesës fetare, i cili duhet të jetë shembull edhe për të gjithë botën, e bën akoma më të drejtë zgjedhjen për të qenë në Shqipëri me këtë festival.

Sa i takon marrëveshjes me universitetin "Lu arasi" ne do të kemi një shkëmbim eksperiencash me rrjetin më të madh të vullnetarëve të cilin unë drejtoj, ku student të këtij universiteti do kenë mundësinë të kryejnë aktivitete vullnetare në të gjithë Europën dhe gjithashtu vullnetarë nga e gjithë Europa të jenë në Shqipëri dhe në universitetin "Lu arasi" për të dhënë eksperiencën e tyre."


Në kërkim, inspektori teknik dhe një tjetër

Kolaudonin automjete jashtë standardeve kundrejt rryshfetit, arrestohen 3 persona

LAÇ - Tre persona janë arrestuar nga policia e Laçit dhe dy të tjerë janë shpallur në kërkim, njëri prej të cilëve inspektori i kontrollit teknik në këtë qytet. Mësohet se personat e vënë në pranga dhe ata në kërkim akuzohen se në pikën e kolaudimit në Laç kalonin mjete jashtë standardeve teknike kundrejt rryshfetit. Specialistët e Seksionit kundër krimit Ekonomiko-Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, nga informacionet e siguruar në rrugë

policeore dhe mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm se tek pika e kolaudimit në Laç kaloheshin makina jashtë standardeve teknike kundrejt rryshfetit, në vitin 2018 kanë referuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin materiale hetimore. Mbi bazën e atyre materialeve, prokuroria ka regjistruar procedim penal për ndjekje të mëtejshme të këtij rasti, i cili është finalizuar dhe me operacionin e koduar "Kolaudimi" ku janë ekzekutuar urdhrat e masave të sigurisë në ngarkim të shtetasve: S.K., 22

vjeç, banues në Mamurras, me masë sigurimi "Arrest me burg" për veprat penale: "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike"; M.K., 50 vjeç, banues në Mamurras, me masë sigurimi "Arrest me shtëpi" për veprën penale: "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" si dhe I.D., 49 vjeç, banues në Lezhë, me masë sigurimi "Arrest me shtëpi" për veprën penale: "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funk-



sione publike". Ndërkaq, janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e shtetasve: D.A., 47 vjeç, banues në Laç, me masë sigurimi "Arrest me burg" për veprën penale: "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" dhe G.J.A., 33 vjeç, banues në Lezhë, me detyrë Inspektori i Kontrollit Teknik tek SGS Laç, me masë sigurimi

"Arrest me burg" për veprën penale "Shpërdorim detyre". Masat e sigurisë janë dhënë nga Gjykata e Shkallës Parë Kurbin datë 16.04.2019, ndaj këtyre shtetasve të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një mjet jashtë standardeve teknike, i kaluar në kolaudim pa probleme dyshuar kundrejt rryshfetit.

Reagojnë prindërit: Drejtësia nuk funksionoi, na vranë familjarisht

Akuzohet për vrasje në Angli, gjykata spranon ekspertim mendor të 23-vjeçarit

Togat e zeza vendosin ekstradimin e Elton Sefës

DURRËS

Gjkata e Durrësit ka vendosur që 23-vjeçari Elton Sefa të ekstradohet në Angli, duke mos pranuar kërkesën e avokatit mbrojtës për ekspertim të gjendjes mendore të të riut. Vendimi u mor në seancën e djeshme, ku togat e zeza të qytetit bregdetar vendosën pro ekstradimit të Sefës. Ai akuzohet për vrasjen e punëdhënësit të tij në Angli rreth një vit më parë. Arsen Çaushaj, avokati mbrojtës i 23-vjeçarit, i cili është arrestuar nga policia shqiptare ka kërkuar pezullimin e këtij vendimi duke vënë para gjykatës dhe prokurorit Ilir Turja një sërë dokumentesh që vërtetojnë se i riu me origjinë nga Kukësi është i papërgjegjshëm mendërisht me diagnozën çrregullim psikotik. Rezultoni se 23-vjeçari pasi është kthyer nga Anglia i papërgjegjshëm mendërisht është shtruar në spitalin psikiatrik në Tiranë prej 26 gushtit 2018 deri në 13 shtator 2018. Por këto doku-



23-vjeçari Elton Sefa

mente nuk janë marrë parasysh as nga prokuroria dhe as nga gjykata. Ndërkohë, babai i 23-vjeçarit tregoi kalvarin dhe fatin mizor që e priti në Angli djalin e tij, i cili akuzohet për vrasjen e 47-vjeçarit John Woodward më 17 prill të vitit 2018. Sipas Elmi Sefës djali iku në Angli me kamion, por duke punuar në një kantier ndërtime, aty ka humbur jetën aksidentalisht shtetas britanik. I riu duke qenë se ishte pa dokumente është larguar nga vendi i ngjarjes dhe nga shteti britanik 8 javë pasi kishte mbërritur atje. Në gjendje të rënduar mendore ka ardhur në shtëpi i pavetëdijshëm, çka bëri që familja të kërkonte ndihmë në spitalin psikiatrik. Gjykata e Durrësit nuk e ka pranuar kërkesën e mbrojtjes për ekzaminim ligjor, ndërsa familja dhe mbrojtësi duhet të anulojnë vendimin e ekstradimit drejt Anglisë. Pas dhënies së vendimit, kanë reaguuar prindërit e të akuzuarit, të

cilët u shprehën se drejtësia nuk ka funksionuar. Elmi Sefa deklaroi se me këtë vendim gjykata e Durrësit na ka vranë familjarisht. "Jemi familje të sëmurë, ato nuk shikojnë as prova, as letra. Na kërkojnë të na vrasin, të katër të vrasin. Jam më tepër i kënaqur të na vrasë shteti shqiptar", u shpreh babai i 23-vjeçarit. Ky i fundit pohoi se djali është i pafajshëm dhe i sëmurë që prej një viti. "Nuk ia kam blerë të gjitha ilaçet se nuk kam mundësi, marr pension invalidi", tha Elmi Sefa. Bashkë me prindërit, në seancën gjyqësore ishte edhe e motra, e Elton Sefës, invalide. Elton Sefa do të jetë shqiptari i parë që pritet të ekstradohet në Angli pas një marrëveshjeje me këtë shtet dhe Shqipërisë për ekstradimin e ndërsjellë të shtetasve shqiptarë dhe britanikë, të cilët përfshihen në veprimtari kriminale në dy vendet respektive dhe i fshihen drejtësisë.



Vrasje, vjedhje dhe drogë, Interpol Tirana ekstradon 3 shqiptarë të "rrezikshëm"

TIRANË - Interpol Tirana ka ekstraduar drejt vendit tonë tre shtetas shqiptarë që akuzohen për vepra të ndryshme penale si vrasje, vjedhje e kultivim bimësh narkotike. Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tirana me Interpol Wiesbaden, u bë i mundur arrestimi dhe ekstradimi nga Gjermania drejt vendit tonë i të dënuarit, shtetasit shqiptar Ilir Kapllanaj, 49 vjeç, banues në Pier Ky shtete ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor e ka dënuar me 23 vjet burg për veprën penale, "Vrasje me pararendim kryer në bashkëpunim". Mësohet se Kapllanaj, në bashkëpunim me 3 shtetas të tjerë, në 25 shkurt 2000, kanë vrarë me armë zjarri shtetasin G.L., banues në Patos. Po si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tiranës me Interpol Romën, u bë i mundur arrestimi në Itali, duke u finalizuar me ekstradimin drejt vendit tonë i shtetasit G.L., 28 vjeç, banues në Tropojë. I riu ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dënuar këtë shtetas me 1 vit e 4 muaj burg për veprën penale "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik, duke ushtruar dhunë fizike, kryer në bashkëpunim". Po këtë shtetas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dënuar shtetasin G.L., me 4 vjet burg, për veprën penale "Vjedhje, e kryer në bashkëpunim". Gjithashtu, falë bashkëpunimit të Interpol Tiranë me Interpol Romën/Itali, u bë i mundur arrestimi në Itali, duke u finalizuar me ekstradimin drejt vendit tonë, i shtetasit R. R., 54 vjeç, banues në Vlorë. Shtetasi R. R. ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Z.Q.K Interpol Tirana, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur masën e sigurisë arrest me burg për veprën penale "Grupit të Strukturave Kriminale" dhe "Kultivimit të bimëve narkotike"

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BANKA E SHQIPËRISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përskrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

KAKAVIJË - Një sasi e konsiderueshme ilaçesh kontrabandë raportohet të jetë bllokuar përgjatë ditës së djeshme në Kakavijë. Sipas policisë, ilaçet u gjenden të fshehura brenda një autobusi të linjës Greqi-Shqipëri, me drejtues shtetasin me iniciale V.V. "Specialistët të strukturave të Drejtorisë Antitrafik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doga-

Bllokohen ilaçe kontrabandë në autobusin e linjës Greqi-Shqipëri

nave, në bashkëpunim me Degën Doganore Kakavijë, kanë bllokuar në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë ilaçe kontrabandë. Gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit në autobusin e linjës Greqi-Shqipëri, me drejtues mjeti me iniciale V.V, u konstatua një kuti, e cila në përmbajtje të saj kishte një sasi të konsiderueshme ilaçesh kontrabandë. Mënyherë strukturat e Drejtorisë Antitrafik dhe Degës Doganore Kakavijë kanë bërë bllokimin e tyre", - njoftoi policia.

TIRANË

Skandali, Rinasi pa siguri edhe për bagazhet. Policia kërkesa për shtimin e masave

Megagrabitja në aeroportin "Nënë Tereza", gjenden gjurmë gishtash në furgonin e autorëve

Merret në pyetje gruaja e Admir Muratajt. Në bastisjen e 9 prillit dyshohet se janë të përfshirë 3 grupe kriminale

Policia ka zbuluar gjurmë gishtash në furgonin që u përdor nga grabitësit në Rinas. Prokurorët besojnë se ekzaminimi i gjurmëve mund të çojë në identifikimin e autorëve të tjerë. Sipas burimeve të Tv.Klan, përgjigja e laboratorit të policisë shkencore pritet të vijë brenda kësaj jave. Shtatë ditë pas grabitjes së 6.5 milionë eurove në pistën e aeroportit të Rinasis, prokuroria ka filluar marrjen në pyetje të personave që konsiderohen të vlefshëm për hetimin. Ndër ta, është pyetur dhe bashkëshortja e Admir Muratajt, i cili mbeti i vrarë me plumb në kokë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë. Pavarësisht se konsiderohej dëshmi e rëndësishme, Albana Alidhima nuk ka dhënë shumë detaje të vlefshme. Ajo i ka sqaruar oficerëve se kishte kohë që nuk takohej me Admirin dhe se nuk e dinte ku qëndronte dhe me kë shoqërohej pas arratisjes nga burgu grek i Trikalas në vitin 2013. Hetuesit kanë dyshime se në tre grabitjet e mëparshme ku ka marrë pjesë Admir Muratajt, ka pasur edhe bashkëpunëtorë të tjerë të cilët nuk janë identifikuar. Në grabitjen e 9 prillit dyshohet se janë të përfshirë tre grupe kriminale. Pjesë e dosjes së grabitjes së fundit është bërë edhe ajo qershorit të 2016, ku në pistën e Rinasis u morën 1 milion euro. Për këtë ngjarje u shpall në kërkim Aleks Pepa, ndërsa personat e tjerë që morën pjesë ende nuk janë identifikuar. Pas grabitjes së parave në pistën e Rinasis, një tjetër skandal ka dalë në dritë mbi masat e sigurisë në pistën e aeroportit. Bëhet fjalë për vjedhjen e sendeve nga valixhet e pasagjerëve, ngjarje të ndodhura në mënyrë të përsëritur. Përmes një letre që disponon televizioni Klan, policia e Rinasis u ka bërë një kërkesë kompanive ajrore që të marrin masa për parandalimin e ngjarjeve të tilla. Në letër u kërkohet kompanive ajrore të vendosin kamera portative brenda barkut të avionëve ose bagazhet të ngarkohen në kontejnerë për të shmangur kontaktin me punonjësit. Punonjësit të cilët merren me ngarkimin dhe shkarkimin e bagazheve janë në varësi të kompanisë TIA.



Furgoni i grabitësve ku janë gjetur gjurmët e gishtave



Aeroporti i Rinasis

BASHKËSHORTJA E MURATAJT

Prokuroria ka filluar marrjen në pyetje të personave që konsiderohen të vlefshëm për hetimin. Ndër ta, është pyetur dhe bashkëshortja e Admir Muratajt, i cili mbeti i vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë. Pavarësisht se konsiderohej dëshmi e rëndësishme, Albana Alidhima nuk ka dhënë shumë detaje të vlefshme. Ajo i ka sqaruar se kishte kohë që nuk takohej me Admirin dhe se nuk e dinte ku qëndronte dhe me kë shoqërohej pas arratisjes nga burgu grek i Trikalas.

KËRKESA PËR KOMPANITË AJRORE

Përmes një letre që disponon televizioni "Klan", policia e Rinasis u ka bërë një kërkesë kompanive ajrore që të marrin masa për parandalimin e ngjarjeve të tilla. Në letër u kërkohet kompanive ajrore të vendosin kamera portative brenda barkut të avionëve ose bagazhet të ngarkohen në kontejnerë për të shmangur kontaktin me punonjësit. Punonjësit të cilët merren me ngarkimin dhe shkarkimin e bagazheve janë në varësi të kompanisë TIA.

"Njoftuam policinë sapo pamë furgonin t'i afrohej avionit"

Vjedhja spektakolare në Rinas, zyrtarët e TIA-s: Grabitësit përdorën "crash doors"

TIRANË - Punonjësit e sigurisë së TIA-s janë zyrtarët e parë që kanë dhënë shpjegimet e tyre lidhur me supergrabitjen në pistën e aeroportit, mesditën e 9 prillit, kur një grup kriminal me në krye Admir Muratajt morën afro 10 milionë euro, ndërsa 47-vjeçari mbeti i vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë. Zyrtarët e sigurisë së aeroportit iu kanë sqaruar hetuesve se kanë zbatuar rregullat e sigurisë dhe se grabitësit përdorën ato që quhen "crash doors", për të hyrë dhe për të dalë nga aeroporti. Sipas tyre, këto dyer nuk janë të një sigurie të lartë, që në raste avarie apo të rrëzimit të një avioni, makina e zjarrfikëses të depërtojë në pistë duke i shkatërruar ato. Kjo ngre dyshime se forta, se grupi kriminal ka pasur informacion për këtë detaj mjaft të rëndësishëm dhe ka përdorur pikërisht këto dy dyer, atë të anës juglindore për të hyrë në pistë dhe atë të anës verilindore për t'u larguar, pasi përmes tyre mund të depërtohej lehtë. Lidhur me këtë pretendim të ngritur nga zyrtarët e TIA, prokuroria deklaroi se ka sekuestruar të gjitha konventat, apo marrëveshjet pranë zyrave të këtij institucioni, atij të Autoritetit të Avia-



hyrë në pistë dhe atë të anës verilindore për t'u larguar, pasi përmes tyre mund të depërtohej lehtë. Lidhur me këtë pretendim të ngritur nga zyrtarët e TIA, prokuroria deklaroi se ka sekuestruar të gjitha konventat, apo marrëveshjet pranë zyrave të këtij institucioni, atij të Autoritetit të Avia-

cionit Civil apo kompanisë ICTS, të cilat do të analizohen në përputhje me faktet e rrethanat konkrete të ngjarjes. Një tjetër aspekt që po hetohet nga institucioni i akuzës është momenti i njoftimit të policisë për hyrjen brenda pistës të automjetit me shkrimin "hetimi taimor". Policia nga ana e saj

deklaroi se njoftimin për ngjarjen e mori jo nga autoritetet e aeroportit, por nga burime të tjera. Ndërsa zyrtarët e aeroportit pretendojnë se kanë njoftuar policinë sapo konstatuan çarjen e derës dhe panë furgonin t'i afrohej avionit të linjës Tiranë-Vjenë. Anëtarët e grupit kriminal depërtaun në pistë dhe në barkun e avionit që pritej të nisej në fluturim grabitën shumën e majme të parave. Pavarësisht hetimeve intensive, prokuroria ende nuk ka mundur të identifikojë bashkëpunëtorët e tjerë të Admir Muratajt, ndërsa lidhur me këtë të fundit nuk është përcaktuar nëse është vrarë nga policia apo gabimisht nga miqtë e tij gjatë shkëmbimit të zjarrit.



Grabitja e Rinasis, deputeti Baraj: Përgjegjësia e ka koncesionari

TIRANË - Për deputetin e Partisë Socialiste, Besnik Baraj, grabitjet si ajo e Rinasis mund të ndodhin në çdo vend të botës. Ai ishte i ftuar në studion e ABC News, ku tha se përgjegjësinë për sigurinë në aeroport e ka koncesionari. Mund të ndodhë në çdo kohë dhe në çdo vend të botës, ku politika duket se është e pandershme. Me ligj e ka përgjegjësinë për mbrojtjen e territorit brenda këtij perimetri e ka koncesionari. Është kjo arsyeja që qeveria për shkak të sensibilitetit mori këtë përgjegjësi që ne e kemi parë në Rinas, ku është Policia Ushtarake dhe Policia e Shtetit", tha Baraj. Për sa i përket akuzave se vjedhja në aeroport është krim shtetëror, deputeti tha se është e papranueshme të abuzohet me dëkta të tillë nga partitë. Ai theksoi se ky krim duhet dënuar nga të gjitha forcat politike në Shqipëri. Gjithashtu, Baraj mbrojti edhe regjimin e ministrit të Brendshëm, Sander Lleshaj. Deputeti socialist theksoi se reagoni i policisë ishte i jashtëzakonshëm. "Nga njëherë reagoni i opozitës është aq i politizuar, aq tendencioz që të bën të mbrohesh në një formë jo simetrike por në një formë të tillë për të thënë jeni ju faktorë që nxisni këto ngjarje. Nga pikëpamja ligjore është detyrimi i koncesionarit për të pasur siguri në të gjithë aeroportin. Reagoni i policisë ka qenë i jashtëzakonshëm në atë përplasje. Le t'ia lehtë hetimit të zbulojë si qëndron e vërteta", tha Baraj.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me Përbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga "Ibrahim Rrugova", Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 17.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi III - të për shfajësuar e pasurisë së paluajtshme, Apartamenti me numër pasurisë Nr.5264ND+1-2, Zona Kadastrale 6250, Volumi 20, Faqe 116, me sipërfaqe 137 m², ndodhur në adresën, Bullevari "Zhan D'Am", Tiranë, pronësi: Z.Bagar Musa Kajtaxhi, me vlerë filltare në ankand 62294.4 (Sjashitëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë pikë) EURO.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com;

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me Përbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga "Ibrahim Rrugova", Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 03.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi I - të për shfajësuar e pasurisë së paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 3104 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës, me Nr.pasurie 16/131, Volumi 11, Faqe 10, Zona Kadastrale 8516, në pronësi të Shoqërisë "ADRIATIKABETON" sh.p.k, me vlerë filltare në ankand 322.816 (Treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) Euro.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko

Njoftim shitje me ankand
Shoqëria përbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 310 m² dhe ndërtesë 96 m² No. nr. pasurie 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdi Demir Trojani e regjistruar në ZVRPP Durrës.
Cmimi i ankandit të trete është EUR 21.600 (njëzet e një mijë e gjashtëqind euro)
Ankandi zhvillohet dt. 10/05/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë. Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

Si do të ndahen paratë e buxhetit

Qeveria, 109 milionë lekë për komunitetet fetare

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për masën e financimit të komuniteteve fetare për vitin 2019. Referuar vendimit, masa e financimit është 109 milionë lekë. Komiteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 824 000 lekë, të ndarë në: 11 544 000 lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 74 punonjës të administratës; 20 280 000 lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 130 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauni-

versitar dhe universitar. Sipas vendimit, mësohet se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 25 740 000 lekë, të ndara në: 20 592 000 lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 132 punonjës të administratës; 5 148 000 lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 33 punonjës të institucioneve të arsimit parash-

kollor, parauniversitar dhe universitar. Ndërkohë, Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 740 000 lekë, të ndarë në: 6 240 000 lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të administratës; 19 500 000 lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 125 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversi-

tar dhe universitar. Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 25 696 000 lekë, të ndarë në: 4 056 000 lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 26 punonjës të administratës; 14 640 000 lekë, për ndërtimin e Teqesë së Elbasanit; 7 000 000 lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore, me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së vep-



rimentarisë së saj jashtë vendit. Shuma do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në

kërkesën e vitit 2019, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur. Kalimi i fondit do të bëhet njëherësh brenda muajit prill të vitit 2019.

Miratohen shpronësimet e pronarëve të "Pallati me Shigjeta" - rrethrotullimi "Shqiponja"

"Unaza e Madhe", 10 milionë euro për pronat që merr rruga

VKM-ja: Pezullohen transaksionet me pronën

Pronat që do të preken nga ndërtimi i "Unazës së Madhe" në segmentin nga "Pallati me Shigjeta"-rrethrotullimi "Shqiponja" do të kompensohen. Vlera e pronave arrin në rreth 10 milionë euro. Lista e përfituesve është përgatitur dhe pritet hyrja në fuqi e vendimit për ndarjen e parave. Ndërkohë, është vendosur pezullimi i transaksioneve me këto pronat. Këto janë pikat kryesore të vendimit që u miratua dhe në mbledhjen e qeverisë, i cili i hap rrugë edhe fillimit të projektit.

VENDIMI I QEVERISË

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i segmentit rrugor "Pallati me Shigjeta"-rrethrotullimi "Shqiponja". Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen do të të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, për pasuritë e llojit 'truall', 'tokë arë' dhe 'ndërtesë', me një vlerë të përgjithshme prej 1 miliard e 224 milionë e 874 mijë lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit do të përballohet nga llogaria 'Fondi i shpronësimeve' në Bankën e Shqipërisë, ndërsa shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 lekë të përballohen nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar. Shpronësimi do të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare".

KOMPENSIMI

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar. Vendimi për cakton



se Agjencia Shtetërore e Kadastrës brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar do të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si-

pas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësive për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e

shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e

Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen do të të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, për pasuritë e llojit 'truall', 'tokë arë' dhe 'ndërtesë',

aktit pa tarifa regjistrimi.

VEPRA

Tenderi për ndërtimin e kësaj vepre është pezulluar pas megaskandalit të publikuar mbrëmë nga emisioni "Të Paekspozuarit", në lidhje me falsifikimet e kompanisë

"Dunwell Haberman" (kompania mëmë e "DH Albania"), fituese e lotit të parë prej 18 milionë euro për rindërtimin e "Unazës së Madhe". Përmes një njoftimi për shtyp, ARRSH bën me dije se ka pezulluar ndërtimin në lotin e parë, ndërsa shton se është në pritje të përgjigjes nga autoritetet amerikane. Emisioni "Të Paekspozuarit" në "News 24" arriti të zbulojë skandalin mbi falsifikimin e firmës nga ana e kompanisë fituese për lotin e parë të "Unazës së Madhe". Kjo kompani ka depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, një letër nga sekretari i Shtetit të Delaware, Jeffrey Bullock, për të vërtetuar se kompania është themeluar në vitin 1998. Por pas verifikimeve, "Të Paekspozuarit" zbuluan se ky dokument ishte i falsifikuar.

Financat, plan 3-mujor për pagesat

Rimbursimi i TVSH-së, bizneset që do të kenë prioritet

Fasonët, grumbulluesit dhe eksportuesit janë kategoritë e bizneseve që do të përfitojnë të parët rimbursimin e TVSH-së. Përmes një plani 3-mujor, Ministria e Financave bën të ditur skemën e shpërndarjes. Detyrimet që ka shteti ndaj bizneseve parashikohet që të shlyhen brenda qershorit. Detajet mbi planin e pagesave janë bërë të ditura gjatë një takimi konsultues organizuar nga Ministria e Financave dhe Sekretariati i Këshillit të Investimeve, ku ndër të tjera është vënë theksi

edhe të problematika e informalitetit në sektor: "Informaliteti është një faktor që ka kushtëzuar kohë pas kohe buxhetin në vend dhe për këtë kërkohet edhe ndërgjegjësimi më i madh i komunitetit të biznesit jo vetëm për të adresuar këtë problematikë, por edhe për të hapur debat në lidhje me modelin e përshtatshme ekonomike, që garantojnë rritjen ekonomike dhe mospërsëritjen e cikleve të tilla. Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve do të konsiderojnë si prioritet subjektet grumbullues, fason dhe eksportues dhe do të fokusojnë përpjekjet e

tyre në ndërgjegjësimin e biznesit, ndërkohë kanë planifikuar reformimin e administratës tatimore dhe veçanërisht të hetimit tatimor", thuhet në përmblidhjen e bërë nga sekretariati i Këshillit të Investimit lidhur me takimin e pak ditëve më parë. Nga ana tjetër, bizneset kanë shprehur shqetësimet e tyre sipas

sektorëve, ku për sektorin e fasonëve është kërkuar që kompensimi i TAP dhe kompensimi i sigurimeve shoqërore në rast vonese të rimbursimit të TVSH-së të shihet me prioritet, ashtu sikurse impakti i zhvlerësimit të monedhës euro, nevoja e industrisë së bimëve aromatike dhe medicinale për t'u ripërfshirë në skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit (si p.sh. IPARD Like, IPARD 2, AZHBR); disa opsione mbi taksimin dhe nivelin e rrogave të sektorit, nevoja për më shumë subvencionime nga shteti.

Aksioni i Tatimeve, me asistencën e ngushtë të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Kreu i Tatimeve, Duro: Do të kontrollojmë 14 mijë bar-restorante

Lufta anti-informalitet, ja çfarë do të verifikojnë tatimorët

Rreth 14 mijë bar-restorante do të kalojnë në sitën e tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton se nisi zbatimin në nivel kombëtar të një plani për menaxhimin e riskut në sektorin e bar-restoranteve, me qëllim ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për vetëdeklarim korrekt. Lajmi është bërë i ditur nga kreu i "Tatimeve, Elton Duro. "Ky plan është hartuar me asistencën e ngushtë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili do të ndjekë në vijimësi edhe zbatimin e tij, duke sjellë për herë të parë në Shqipëri praktikën tatimore të trajtimit të riskut me metodologji bashkëkohore", tha dje drejtori i përgjithshëm i "Tatimeve", Elton Duro. Me këtë qasje DPT synon të komunikojë të tatimpaguesit e këtij sektori, përfitimet që kanë nga deklarimi i saktë i të dhënave tatimore, për të forcur tek ata bindjen se ligji është i barabart për të gjithë, shtoi ai. "Qëllimi ynë nuk është të penalizojmë, por të marrim angazhimin e tyre për përbushje të detyrimit në të ardhmen, një tatimpagues korrekt nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Nëse qëllimshëm zgjedhin të mos jenë korrekte, atëherë administrata tatimore do të vijojë me vlerësimet sipas legjislacionit në fuqi", - tha drejtori i përgjithshëm i "Tatimeve", Elton Duro. Ky sektor është përzgjedhur pas



Kreu i Tatimeve, Elton Duro

PLANI

"Plani është hartuar me asistencën e ngushtë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili do të ndjekë në vijimësi edhe zbatimin e tij, duke sjellë për herë të parë në Shqipëri praktikën tatimore të trajtimit të riskut me metodologji bashkëkohore", tha dje drejtori i përgjithshëm i "Tatimeve", Elton Duro.

vlerësimit analitik të deklarimeve të tyre tatimore, si një kategori me risk në përbushje, formalizimi i të cilit lidhet ngushtë edhe me sektorë të tjerë si tur-

izmi, tregtia, shërbimet etj..

KONTROLLET

Rreth 14,000 tatimpagues të këtij sektori do të nxiten dhe ndihmohen që të përbushin në mënyrë kor-

rekte detyrimet si edhe t'i vetëkorrigjojnë ato, duke reflektuar aktivitetin real që ushtrojnë. Tatimpaguesit e këtij sektori në të gjithë vendin do të vihen në dije-

VLERESIMET

"Qëllimi nuk është të penalizojmë, por të marrim angazhimin e tyre për përbushje të detyrimit në të ardhmen, një tatimpagues korrekt nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Nëse qëllimshëm zgjedhin të mos jenë korrekte, atëherë administrata tatimore do të vijojë me vlerësimet sipas legjislacionit në fuqi".

REKOMANDIMI

Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore i kanë sugjeruar qeverisë shqiptare të jetë më e qëndrueshme në politikat fiskale, shqetësim që është ngritur edhe nga sipërmarrjet, të cilat jo në pak raste e kanë pësuar nga ndryshimet e shpeshta fiskale. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, i është përgjigjur interesit të mediave lidhur me vizitën dhe takimet me institucionet ndërkombëtare në SHBA, ku theksoi se po merren masat që politikat fiskale të jenë më të qëndrueshme. Një tjetër shqetësim i institucioneve ndërkombëtare lidhet me menaxhimin e shpenzimeve dhe monitorimin e kontratave koncesionare. Më herët, ministria Denaj mori pjesë në aktivitetin e Bankës Botërore, ku u prezantua projekti "Sistemi i integruar i financave publike", i cili ka në thelb rritjen e transparencës në menaxhimin e fondeve publike.

Deklarata vjetore e të ardhurave, mbi 2 milionë lekë

'Tatimet': 30 prilli afati i fundit, penalitet për shkeljet



SHKALLA E TAKSIMIT

- Për shumën e pagave mujore deri 30,000 lekë tatimi është 0%.
- Për shumën e pagave mujore nga 30,001 lekë - 130,000 lekë tatimi është 13% e shumës mbi 30 000 lekë.
- Për shumën e pagave mujore nga 130,001 lekë e më tepër tatimi është 13,000 lekë, plus 23% e shumës mbi 130,000 lekë.

Të gjithë tatimpaguesit me të ardhura në shumën mbi 2 milionë lekë duhet të dorëzojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave të vitit 2018 brenda datës 30 prill. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kjo deklaratë duhet të paraqitet njëkohësisht edhe nga individët jorezidentë në vendin tonë, që realizojnë këtë vlerë të ardhurave të tatueshme. Më konkretisht, tatimpaguesit janë të detyruar të deklarojnë të ardhurat e tatueshme që përfshijnë: të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit, të ardhurat bruto nga dividenti, të ardhurat bruto nga qiraja, fitimi kapital nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit, të ardhura bruto nga interesat bankare, fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme, shuma bruto të fituar nga lotaria apo lojëra të tjera të fatit. DPT sjell në vëmendje të tatimpaguesve që të bëjnë kujdes gjatë plotësimit të saktë të deklaratës, veçanërisht në llogaritjen e tatimit mbi të

ardhurat nga punësimi, në rastet kur individi përfiton dy apo më shumë paga në një muaj nga punëdhënësi të ndryshëm, në të kundërt, kjo mund të shoqërohet edhe me penalitete. Tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët është kuti e lirë boshe në deklaratë dhe plotësohet nga vetë deklaruësi. Individit deklaruës do të llogarisë tatimin mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet për të gjitha të ardhurat nga pagat që përfitohen gjatë muajit, edhe në rastin kur ai i përfiton këto paga nga punëdhënësi të ndryshëm. Në rastin kur shuma e të ardhurave të përfituara gjatë muajit nga dy apo më shumë paga tek punëdhënësi të ndryshëm e kalojnë vlerën që tatonet me zero për qind (30,000 lekë), tatimi do të llogaritet mbi totalin e të ardhurave mujore nga pagat (totali i të ardhurave nga pagat tek të gjithë punëdhënësit).

Pranimet në TND-në e administratës publike

Miratohet kuota për vitin 2019, kriteret që duhen plotësuar

Procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND) në administratën publike do të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND. Vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon se për vitin 2019, pranimi në TND do të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një konkursi kombëtar. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është 8. Vendimi përcakton se kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil janë: a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master shkencor" ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomati, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi. c) Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlefshme në: institucione të administratës publike; institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij; shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit, ose nuk janë në proces kundër tij; organizata jofitimprurëse, të cilat kanë të paktën 5 (pesë) vjet që janë krijuar. Kandidatët duhet të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si dhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.




Çuditshmëria e Dantes, Beatricija dhe alegoria poetike teologjike

Nga Harold Bloom

Historianët e rinj dhe të mlfilosurit e tjerë në aleancë përreth tyre janë përpjekur ta ulin në rëndësinë e tij Shkëspirin, ta fragmentarizojnë dhe hapërdajin atë, duke synuar me këtë përpjekje ta zhbëjnë Kanonin (Listën e Shenjtë të autorëve të mëdhenj) të Letërsisë Perëndimore, duke shpërbërë kështu një nga bërthamat e tij. Për t'u habitur, Dante, ose bërthama e dytë e këtij Kanoni, nuk është nën një kasaphanë të tillë, as në SHBA dhe as në Itali. Padyshim se sulmi do të vijë, qëkur se multikulturalistët e gjithëfarëlllojshëm vështirë se mund të gjejnë një poet më të madh për t'u kundërshtuar sesa Dante, shpirti i fuqishëm dhe i egër i të cilit është politikisht jokorrekt në shkallën më sipërore. Dante është ndër shkrimtarët e mëdhenj perëndimorë, më agresivi dhe polemizuesi, duke eklipsuar madje në këtë drejtim edhe Miltonin. Ashtu si Miltoni, ai ishte jo thjesht një individ apo poet, por një parti politike, duke përfaqësuar sektin e një njeriu të vetëm. Sakaq, identiteti i tij i vërtetë prej heretiku ka qenë i maskuar nga komentet shkollareske, të cilat, edhe në rastin më të mirë, shpesh e trajtojnë si të ishte "Shën Agustin vjershëtor". Por më e mira e të mirave është t'ia nisim duke shënuar guximin e tij të jashtëzakonshëm, të cilit nuk i gjenet shoku në të gjithë traditën e të ashtuquajturës letërsisë së krishterë, duke përfshirë këtu edhe Miltonin.

Askund dhe në asgjë tjetër në letërsinë perëndimore, në të gjithë ciklin e saj jetëgjatë, me shtrirje që zë fill nga Jehovai dhe Homeri, për të vazhduar më pas përmes rrjedhës së shekujve në të tjerë autorë, dhe duke mbërritur deri tek Xhojsi dhe Bekeiti, nuk na shfaqet apo përfaqësohet çlirimi përmes letërsisë i një shpërthimi kaq të egër sesa ekzaltimi i Dantes për Beatricen, e sublimuar prej poetit nga imazhi i një dëshire, në cakum më të lartë të statusit engjëllor, dhe e shndërruar pas ngjites në lartësinë sublime të këtij roli edhe në elementin crucial të shpëtimin në hierarkinë kishitare. Për shkak se Beatricija fillimisht ka rëndësi vetëm si një instrument i dëshirës vetjake të Dantes, apo teozos e saj përfshin gjithashtu pashmangshëm dhe njëherazi po aq edhe zgjedhjen e tij vetanake. Poema "Komedia Hyjnore" është një profeci, e cila merr funksionet e një Dhiatë të Tretë, pa kurrfarë lidhjeje varësie me Dhiatën e Re dhe të Vjetër, dhe që nuk u kryen atyre kurrfarë shërbimi. Dante nuk do ta pranonte se "Komedia Hyjnore", fikcioni i tij sipëror; duhej të ishte një trillim apo sjaim letrar. Përkundrazi, edhe më mirë, poema përfaqëson të vërtetën universale dhe jo atë të përkohshmen dhe kalimtare e kësaj bote. Ajo që ai e sheh



si pelegrin për ta shprehur më pas si poet ka për qëllim të na bindë deri në pafundësi se ai e ka të pamundur të dalë dhe t'i shpëtojë si poetikës, ashtu edhe fetarizmit. Gjestet e përlusës në poemë, të kryera nga pelegrini apo poeti, lënë përshtypje tek shkolllarët e Dantes, por në të vërtetë janë më pak bindëse sesa subversoni i poemës ndaj të gjithë poetëve të tjerë dhe sesa këmbëngulja në vazhdimësi e vetë poemës për të nxjerrë në ballë të saj, potencialin apokaliptik të Dantes.

Këto vëzhgime, nxitjet të shpjegohem, janë të drejtuara më së shumti kundër studiimeve shkollareske rreth Dantes dhe aspak kundër atij. Nuk shoh ndonjë mënyrë sesi ne mund të lironjë, duke e shkëputur nga njëri-tjetri, fuqinë marramendëse poetike të Dantes nga ambiciei e tij të shpirtëzimit, të cilat janë pashmangshmërisht të veçanta (idiosinkratike) duke qenë se shprehin shijet e tij personale, të cilat i shpëtuan damkosjes si blasfemike vetëm sepse ja doli ta fitonte bastin me ardhmërinë brenda një gjenerate nga vdekja e tij. Nëse "Komedia Hyjnore" nuk do të ishte rivali i vetëm autentik poetik i Shkëspirin, Beatricija do të ishte një ofendim jo vetëm për Kishën, por edhe për shkrimtarët apo letrarët katolikë. Për një poet neo-të krishterë si T.S. Eliot, "Komedia Hyjnore" është tepër e fortë dhe e theksme për t'u mohuar nga të krishterët, aq sa të mos e njohin si të tyren. Kësisoj, poema bëhet për ta

një tjetër Shkrim i Shenjtë, Dhiata më e re, në shtojcë të Biblës së krishterë kanonike. Charles Williams-një guru për neo-të krishterë të tillë si Eliot, W.C.S. Lewis, W.H. Auden, Dorothy L. Sayers, J.R.R. Tolkien dhe të tjerë, shkojnë larg sa të pohonte duke shpallur si të vërtetë se besorja Athanasjane "për ta sjellë Njerëzimin tek Perëndia" nuk gjeti shprehje të plotë deri përpara shfaqjes së Dantes. Kështu pra, Kishës i ishte dashur të priste për Danten dhe për figurën e Beatricës.

Ajo çfarë Williams përvijon shndritshëm në brendësi të të gjithë studimit të tij intensiv "Figura e Beatricës" (1943), është skandali më i madh i aritjes së poemës, shpikja më spektakolare e poetit; Beatricija. Asnjë personazh i vetëm i Shkëspirin, as Hamleti karizmatik dhe as Liri i ngjashëm me Zotat nuk arrijnë të krahasohen me Beatricen si një invencion letrar i guximshëm, i papërmbytshëm, me kaq tepri i spikatur. Vetëm J e shkrimtarit të Yahweh, dhe Ungjilli i Markut për Jezusin janë reprezentacione më surprizuese dhe të ekzaltuara sesa Beatricija. Kjo e fundit është nënshkrimi për originalitetin e Dantes dhe vendosja e saj triumfuese në së miri brenda makines së kristiane të shpëtimin është akti më i guximshëm që kryen poeti me poemën, akt që synon ta transformojë fenë e tij të trashëgurojë në diçka më së shumti për veten e tij.

Shkolllarët e Dantes me neveri i hedhin poshtë si të pavërteta pohime të tilla të

miat, por duke më gjykar kësaj, atyre umbetet të jetojnë nën hijen e subjektivitetit të tyre të studimit, sepse në këtë mënyrë ata prirën ta humbasin vetëdijësimin e plotë mbi çuditshmërinë, apo ekstravagançën e "Komedisë Hyjnore". Poema mbetet vepra letrare më e panatyrshme apo e pashpjegueshme që mund të ndeshet nga lexuesi ambicioz, e cila i mbijeton si përkthim, i ashtu edhe mësimdhënies së gjerë. Gjithçka që i mundëson dhe i lejon lexuesit të zakonshëm mësimin e "Komedisë" vjen nga cilësia e shpirtit të Dantes, që mund të jenë gjithçka, me përjashtim të asaj që njihet si besimi i i shtëfalë i një shprese të kotë, apo rrëfimi i një jete të shenjtëruar nga fryma e hirit të dhënë nga Perëndia për përlusësinë. Më së fundmi Dante nuk ka asgjë me të vërtetë pozitive për të thënë për pararendësit apo bashkëkohësit e tij poetë dhe është për t'u vërejtur se me përjashtim të Psalmeve, e përdor fare pak dhe pragmatist Biblën. Duke sikur ai e ndjeu se mbreti David, paraardhësi i Krishtit, ishte i vetmi pararendës i denjë për të, i vetmi poet tjetër që mund ta shprehte në mënyrë të qëndrueshme të vërtetën. Lexuesi i ardhur për herë të parë të Dantja do të shohë se asnjë autor tjetër laik nuk ka një bindje kaq absolute se vepra e tij është e vërteta, gjithçka nga e vërteta më e rëndësishme. Miltoni dhe ndoshta më vonë Tostoi i vijnë afër etjes të papërmbytjave apo bindjes të zjarrtë të të qenurit të drejtë të Dantes, por ata të dy jo vetëm se reflektojnë realitetet të debatueshme, por shfaqin shumë më tepër se ai a tendosje të rraskapitruar nga të kapurit fort pas një vizioni të izoluar individual. Dantja është kaq i fuqishëm në planin retorik, psikologjik dhe shpirtëror, sa që eklipsin vetëbesimin e tyre. Teologjia nuk e sundon, por është burimi i tij, një burim ndërmjet shumë të tjerave. Askush nuk e mohan se Dantja i përket të mbnatyrshmes, duke qenë një i krishterë, një teolog, ose së paku një shprehës alegorik që përdor teologjinë. Por, të gjitha konceptet dhe imazhet që merr nga teologjia kalojnë duke iu nënshtruar transformimeve të jashtëzakonshme poetike të tij. Ai është i vetmi poet, originaliteti i të cilit, dhuntitë inventive dhe pjelloria jonormale e mbnatyrshme, munden të rivalizojnë ato të Shkëspirin. Lexuesi që punon me Danten për herë të parë, nëpërmjet një terza-rima përkthimi i të cilave është i arriret në nivelin e përkryerjes artistike të përkthimit të Lorenve Bin-yonn, ose në versionin e kthjellët në prozë të John Sinclair, humbet një pafundësi

duke mos e lexuar poemën në italisht, por prapëseprapë aty mbetet i njëmendësuar i gjithë kosmosi dantesk i poemës. Por, është e çuditshme dhe sublimja e asaj çfarë mbetet që kanë rëndësinë më të madhe, sepse janë edhe këto të dyja cilësi që përfaqësojnë fuqitë unike krejt të pashoqe poetike, që mbart dhe vë në shprehje artistike në letërsinë botërore Dante, duke përjashtuar këtu vetëm rastin e Shkëspirin. Ashtu si te Shkëspirin, ne gjejmë te Dante një aftësi njohëse të pakrahësueshme, të kombinuar me dhuntinë për invencion, e cila nuk ka thjesht kufij pragmatikë.

Leximi i Dantes ose Shkëspirin është përvoja e përjetimit të limiteve të vetë aritit dhe atëherë ti e zbulon se këto limite ose janë shtrigruar shkajshmërisht, ose janë shpërthyer. Dantja çan përmes limiteve të aritit në mënyrë shumë më personale dhe të hapur sesa e bën Shkëspirin dhe nëse ai është më i mbnatyrshëm sesa Shkëspirin, transcendenca e natyrës tek Dantja mbetet po aq e tija dhe e papërshtitshme, sa ç'është e pashoqë dhe idiosinkratik natyralizimi i Shkëspirin. Aty ku dy poetët e sfidojnë në shumë njëri-tjetrin janë reprezentacionet e dashurisë, e cila për Danten na kthen aty ku dashuria fillon dhe mbaron për të, te figura e Beatricës.

Beatricija e "Komedisë" zë në hierarkinë e Qiejve një vend, kuptimi i të cilit është i vështirë për t'u rrokur. Ne na mungojnë udhëzimet për ta kuptuar atë, nuk ka asgjë në doktrinën që të bëjë thirrje për ekzaltimin e kësaj gruaje të veçantë florentinase, me të cilën Dante ra në dashurinë e amshuar. Komenti më ironik për këtë rënie në dashuri është nga Jorge Luis Borges, te "Takimi me një Ëndërt" në "Inkuizicione të tjera" (1937-1952).

"Të biesh në dashuri është të krijosh një religion me një Perëndi të gabueshme, ose të rremë. Që Dante u bë profeti i një admirimi idhujtar për Beatricen mbetet një e vërtetë e pakundërshtueshme, sepse një herë ajo e vuri në lojë për ta tallur dhe se një herë tjetër e refuzoi prerazi, dhe këto janë fakte që na bëhen të ditura nga Vita Nuova. Disa i përmbahen qëndrimit se këto fakte janë simbolike edhe për fakte të tjera. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, do të na e forconte edhe më shumë qartësinë mbi një dashuri supersticioze dhe të palumtur".

Borges së paku e kthen Beatricen në origjinin e saj si një "takim iluzor" dhe në tjetërsinë e saj enigmatike për të gjithë lexuesit e Dantes.

"Beatricija ekzistoi

pafundësisht për Danten, Dantja ekzistoi fare pak, ndoshta aspak për Beatricen. Nderimi ynë i thellë dhe venerationi bëhen shkak që ne ta harrojmë këtë disharmoni të vajtueshme dhe e cila na zgjon ndjenjen e keqardhjes për poetin. Sakaq, për Danten, ajo mbeti e paharueshme".

Pak rëndësi ka nëse Borges e projektion ironinë që përdor te pasioni i tij absurd për Beatricen Viterbon (në tregimin e tij Kabalistik "Alef"). Ajo çfarë në mënyrë tinëzore dhe dhelpërake mnton të theksojë është shpërpjesëtimi skandaloz ndërmjet të gjitha gjërave që Dantja dhe Beatricija përjetuan së bashku (thuaje asgjë) dhe vizionit të Dantes për apozeonë e tyre të ndërsjellë në Paradiso. Shpërpjesëtimi është rruga me shkëlqim princëror e Dantes për kah sublimja. Ashtu si Shkëspirin, ai mund të heqë qafe dhe ta kapërcëjë çdo pengesë, sepse të dy poetët e jashtëzakonshëm arrijnë të depërtojnë në largësi dhe lartësi, që janë të paparashikueshme se mund të jenë të arritshme nga poetët e tjerë. Ironia që e përkshon tejndanë (ose alegoria) veprën e Dantes është se ai profetizon të ketë limite, edhe pse i dhunon ato. Çdo gjë e konsideruar jetike dhe origjinale për Danten është arbirare dhe personale, por pavarësisht kësaj, ajo jepet nën dukjen e rreme sikur të ishte e vërteta thelbësore, me përdituar vijueshmëri e traditën, besimin dhe racionalitetin. Thuaje pashmangshmërisht, ai lexohet shtrembër deri sa përziej me normativin dhe së fundmi, ne ballafaqohemi me një sukses që vetë Dantja nuk do ta kishte më mirëpritur. Dantja teologjik i teorive moderne amerikane është një përzierje e Shën Agustinin, Toma Akuinasit dhe shokëve të tyre. Ky është Dantja doktrinal, i mësuar si shumë i errët dhe i pakapshëm, si dhe po kaq habitshëm një besimtar i devotshëm, aq sa mund të kuptohet plotësisht vetëm nga mësimdhënësit e tij amerikanë.

Në fakt janë pinjollët shkrimtarë të Dantes kanonizuesit e tij të vërtetë dhe ata jo gjithmonë përbëjnë një përzierje të hapur dhe të harmonishme të të përkushtuarve të tij; Petrarka, Bokako, WChaucer, Shelley, Rossetti, Yeats, Joyce, Pound, Eliot, Borges, Stevens, Bewckett. Ajo çfarë kanë të përbashkët kjo dizyne shkrimtarësh është Dantja, ndonëse bëhen dymbëdhjetë Dante të ndryshme në pasjetën e tij poetike. Kjo është krejtësisht e përshtatshme për një shkrimtar me fuqinë e tij dhe ka pothuajse po aq Dante, sa ka edhe Shkëspirin.

Përktheu nga anglishtja: **Elvis Zaimi**



ProSEED: Announcement

Social Initiatives – Call for Expressions of Interest and submission of Proposals

The GIZ Program for “Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training” in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Social Initiatives seeks in partnership with local CSOs to foster the inclusion perspectives of marginalized youth in employment and/or education. In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) submission of project Proposals from **19 April – 10 May 2019** at giz-albanien@giz.de. The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging up to 50,000 EURO (equivalent in ALL).

Main Steps of the Procedure:

First step: (i) Expressions of Interest
All interested CSO at least with 2 years of experience implementing projects in the field of youth empowerment shall write to giz-albanien@giz.de, with the following text:

“We herewith declare our interest to participate in the 3rd Call for Proposals, organized by the GIZ ProSEED programme under the Social Initiatives Component. Please send us the respective Application Package”.

Second Step: (ii) Submission of Application.
Upon receipt of the application package the CSO should consult the Application Guidelines to prepare their project proposals for all related eligibility criteria. The Application Guidelines (a separate document) can be downloaded from the ProSEED Facebook page. Deadline for the submission of application is **10 of May 2019**.

The application package must be submitted electronically in English at giz-albanien@giz.de. Applications submitted in hardcopies shall not be taken into consideration. (Applying CSOs must take care to submit the budget in excel as a separate template and not merge it with the project description).

Third Step: (iii) Assessment and Evaluation of Proposals
Upon submission of the proposals by the CSOs the assessment and evaluation procedure shall be implemented as described in the Application Guidelines. For more information and the timeline of procedure please consult the Application Guidelines of this 3rd Call for Proposals.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to express your interest and receive the application package.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period **19 April – 10 May 2019**.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 16 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

| Nr | Përshkrimi i Produktit | Çmimi prej datës 16.04.2019 (përfshirë TVSh-në) |
|----|------------------------|---|
| 1 | HEETS (SILVER LABEL) | 320 Lekë/ paketë |

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670



Projects on “Social Rights for Vulnerable Groups” and “Migration”

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people’s living conditions on a sustainable basis.

Background of the project

Since 2015 GIZ has been supporting the Western Balkan in addressing and fulfilment of social rights for the most vulnerable groups in Western Balkan countries through a Regional Project on Social Rights for Vulnerable Groups/SoRI. The main TC measure is: Key stakeholders have improved conditions for ensuring equal social rights for vulnerable groups in selected municipalities. State actors should be able to fully ensure the social rights of vulnerable groups. Members of vulnerable groups, including vulnerable returnees should be able to demand the fulfillment of their rights on their own. This enables long-term strengthening of social inclusion and reintegration of vulnerable returnees in society and reduces discrimination, reduces de-creases for conflict and encourages peaceful development of the Balkans.

The project is implemented in Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, North Macedonia and Serbia in four fields of activity (FA).

1. The FA “social services” promotes the development of local capacities to offer social services;
2. FA “awareness raising and sensitization” informs and sensitises vulnerable groups on their social rights.
3. The FA “funding local social services” advises local actors in the development of approaches to securing long-term financing for social services for vulnerable groups.
4. The FA “dissemination of experiences” connects actors on the regional level, in order to enable the exchange of local experiences.

Since the year of 2015, GIZ has been also supporting the Western Balkan region in dealing with increased migration movements. A set of interlinked regional migration projects cooperated with the regional partner MARRI (Migration, Asylum, Refugees regional initiative) in order to strengthen the capacities of the institutions dealing with asylum seekers, support asylum seekers directly during their short or medium term stay, strengthen municipalities affected by trans-migration flows as well as raise awareness and understanding on different migration-related topics among asylum seekers and local population. Currently, the areas of activity are the following:

1. Strengthening of regional migration governance and institutional development of MARRI
 2. Direct support to asylum seekers and local population in the Western Balkans
 3. Support for the screening process in Chapter 24 of the accords communautaires in Albania and North Macedonia
- In the framework of these projects, two follow-up projects are currently being developed, which will have a duration until autumn 2022:
- Social Rights for Vulnerable Groups II
 - Preventing and Combating Trafficking in Human Beings in the Western Balkans

GIZ Albania seeks the following staff: Office Manager (maternity leave replacement)

A. Responsibilities

- The office manager is responsible for:
- under the supervision of the National Coordinator/Project Team Leader ensures that all administrative tasks of the project are fulfilled timely and in a competent professional manner;
 - daily secretarial chores of the SoRI-project, THB and the SFF project on migration;
 - ensure all needed organizations are made for different events, meeting, trainings, work-shops as seminars, as planned in the project, according to GIZ rules and regulations;
 - ensure regular communication and flow of information within the project office in Albania and with GIZ country office;
 - ensure regular communication and flow of information with other GIZ SoRI offices dealing with the project (BIH, KOS, MKD, SRB), with the SFF Migration office in Skopje and with other GIZ projects relevant for the fields of intervention of SoRI;
 - filing documents in reference files and/ or in DMS in line with GIZ’s filing rules;
 - assisting the National Coordinator and the National Advisor for Albania and other members of the team in their administrative tasks, as needed;
 - ensure that financial and administrative tasks are fulfilled in compliance with GIZ rules and regulations;
 - preparing Job Cards and contracts for local subsidies and consultancies;
 - ensure that regular reports by local subsidy partners are received, reviewed and advanced, reporting and payments are done as per contracts;
 - ensure that good flow of information and coordination is maintained with all local, central and international partners of GIZ SoRI.

The office manager performs the following tasks:

B. Tasks

1. Secretarial Work and Services
 - Manages incoming and outgoing correspondence;
 - Answers, screens, forwards and/or returns phone calls and messages;
 - Maintains the calendar of project deadlines and events;
 - Supports organising administrative and logistical aspects of project activities;
 - Prepares and organises internal and working meetings and takes minutes;
 - Organises the travelling and accommodation of project staff and of incoming international experts;
 - Ensures meeting of visibility criteria of GIZ;
 - Organises study tours abroad;
 - Ensures guests and experts comfort;
 - Organizes translations of documents and/or interpretation.
 2. Administration
 - Coordinates with the GIZ office on the mode of service delivery;
 - Files the documents in reference files and in DMS in line with GIZ’s filing rules;
 - Edits and files reports and project documents;
 - Ensures that computers and software function properly;
 - Supports procurement processes in accordance with guidelines;
 - Supports the implementation of audit and/ or monitoring missions.
 3. Finance and Accounting
 - Supports monitoring and preparing the monthly accounting and financial plans;
 - Manages the Cash Box of the project;
 - Helps monitoring expenses in accordance with the budget;
 - Prepares invoices and receipts for accounting and executes payments and checks for compliance with GIZ rules;
 - Supports in supervising costs and expenditures of the project budget and helps preparing the financial report of the project.
- (These tasks will be taken over by the OM during the first 3 months of employment under guidance of experienced colleague.)

4. Coordination and Communication
 - Supports the National Coordinator and the National Advisor for Albania in the communication with partners;
 - collects, processes and distributes relevant information.

C. Required qualifications, competences and experience:

- University degree in relevant qualification Finance and/or Business; Management/Administration equivalent of BA or MSc.;
- At least 3 years professional experience in a comparable position;
- Good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office)
- Very good knowledge of English, knowledge of German would be an asset;
- In-depth understanding of financial planning and accounting;
- Customer and service-oriented attitude;
- Excellent communication and organisational skills;
- Willingness to work in a team;
- Willingness to up skill as required by the tasks to be performed.

Contract conditions:

- Full – time employment
 - Project office in Tiraña
 - Assignment period: until 30.09.2019
- Please forward your application until **29th of April 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references. Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Presidenti kosovar: Vuçiç, njeri i vështirë për të negociuar

Takimi në Berlin, Thaçi: S'ka asnjë axhendë të fshehtë

Vuçiç: Kam presione për njohjen e Kosovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se takimi në Berlin do të jetë vijimi i interesimit të Gjermanisë dhe Francës për rajonin dhe për Kosovën. Me një reagim në "Facebook", presidenti shkruan se nuk do të ketë asnjë plan që në takimin e Berlinit të propozohet për marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë. Ai sulmoi hapur edhe zërat kritikë, të cilët kanë hamendësuar për një marrëveshje të fshehtë të Thaçit gjatë qëndrimit të tij në Berlin. "Për më tepër, nuk ka asnjë agjendë të fshehtë prapa këtij takimi. Presim që, në fund, ky takim të rezultojë me një deklaratë retorike të përgjithshme, para-praktisht të dakorduar mes pjesëmarrësve, e cila ndër të tjera do të rikonfirmojë së paku perspektivën evropiane të rajonit tonë, thellimin e reformave sidomos në sundimin e ligjit, si dhe do të theksojë domosdoshmërinë e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", shkruan Thaçi. Gjithashtu presidenti thotë se do të ishte dëshpëruese fakti se nëse Gjermania dhe Franca nuk do të harmonizonin kësaj here qëndrimet për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. "Për Kosovën do të ishte tepër dëshpëruese në rast se edhe në këtë takim, Franca dhe Gjermania, dëshmojnë të harmonizojnë qëndrimet e tyre për vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. Kosova mbetet vendi i vetëm i izoluar në Evropë. Prandaj, të flasësh për perspektivën evropiane të Kosovës, qoftë edhe vetëm në mënyrë retorike, është më tepër se hipokrizi", përfundon ai. Ndërkohë lidhur me taksën e vënë ndaj Serbisë, kryeministri Ramush Haradinaj ka këmbën-



gular se do të hiqet vetëm kur Serbia të njohë Kosovën shtet. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi në intervistën për gazetën britanike "Independent" flet për takimet e tij që ka pasur deri më tash me homologun e tij serb në Bruksel. "Zoti Vuçiç patjetër ka ndryshuar, kryesisht për shkak se ai ka kaluar kohë të vështira për shkak të gabimeve të tij. Regjimi që ai i përkiste dikur ishte i keq, një regjim që bëri shumë dëm jo vetëm për Kosovën, Bosnjën dhe Kroacinë, por edhe vetë Serbisë. Vuçiç është një person shumë i vështirë për të negociuar, për të bërë dialog. Por unë nuk e kam zgjedhur atë si homologun tim, ai nuk më ka zgjedhur mua si homologun e tij. Ky është reali-

teti i këtyre dy shteteve sovrane", ka thënë Thaçi. Ai ka komentuar edhe protestat e opozitës serbe kundër presidentit Aleksandar Vuçiç. "Në vitet 1998 dhe '99, Vuçiç dhe unë ishim në opozitë. Ne fituam, ai humbi. Megjithatë, ai është një udhëheqës legjitim. Liderët në Kosovë dhe Serbi u votuan nga qytetarët. Ne kemi ndryshuar të gjitha në një mënyrë pozitive, ne duhet të evoluojmë. Tani nuk flasim për luftë dhe konflikt, por flasim për arrijten e paqes. Ka pasur demonstrata të fundit në Serbi dhe ekziston rreziku që ata mund të trembin Vuçiçin për arrijten e një marrëveshjeje, por ne nuk shpresojmë. Për fat të keq, gjithmonë do të ketë të tillë që janë kundër paqes", thek-

soi ai. Serbia është nën presion të madh për të njohur Pavarësinë e Kosovës. Kjo ka qenë porosia që Presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, u ka thënë simpatizuesve të tij në një tubim partiak në kryeqytetin serb. Por, Vuçiç u ka premtuar se një gjë e tillë nuk do të ndodh pavarësisht se është bërë gabim që edhe një pjesë e madhe e serbëve ishte kundër zgjidhjes me kompromis. Ai ka thënë se nuk pret shumë nga takimi i liderëve ballkanik në Berlin me insistimin e Kancelares gjermane Angela Merkel dhe Presidentit francez, Emanuel Makron. "Tani e vetmja gjë që kërkojnë është të pranojmë Pavarësinë e Kosovës dhe asgjë më shumë. Do të ketë presione dhe nuk do të na

pyesin më shumë se sa nëse misri duhet të jetë më i verdhë apo vetëm i verdhë. Ju lutem më dëgjoni. Askush nuk ka dashur zgjidhje përveç meje dhe presioni do të shtohet. Tani kemi situatën që na kërkojnë njohjen e Pavarësisë së plotë, as ndarje, por vetëm një Kosovë të tërë të pavarur". Vuçiç ka thënë se Serbia më 6 maj në gjashtë muaj nga tarifat doganore të Kosovës do të marrë masa ndaj Prishtinës. "Nuk ka ngelur asgjë që shqiptarët nuk kanë bërë kundër Serbisë. Nuk kanë formuar asociacionin e ko-

munave serbe dhe kanë vënë taksë. Kanë bërë një platformë nënçmuese dhe kanë miratuar ushtrinë, kundër Kushtetutës së tyre dhe përkundër asaj që edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se ishte kundër, kjo shqiptarëve u lejua". Presidenti serb para takimeve me përfaqësuesit e tjerë ballkanikë dhe ftesës që ka marrë nga Gjermania, do të flasë së pari me përfaqësuesit rusë dhe ata kinëzë. Ka thënë se nuk ka qasje në celular për ata që duan t'i bëjnë presion pa hequr taksat.

Zjarri në Notre Dame, qeveria e Kosovës do të ndajë fonde për restaurimin

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se do t'i propozojë Qeverisë së Kosovës ndarjen e një donacioni për renovimin e Katedrales Notre Dame në Francë, në shenjë mirënjohjeje për ndihmën që i është dhënë në vazhdimësi Kosovës. Këtë deklaratë, Haradinaj e bëri gjatë takimit të Forumit të Nivelit të Lartë për koordinimin e donatorëve, ku shprehu mirënjohjeje për ndihmën e donatorëve për 20 vite radhazi në Kosovë. Katedralja mesjetare Notre-Dame, në zemër të Parisit, u përfshi nga zjarri i madh tri ditë më parë. Zjarri kishte arritur të shpëtojë strukturën kryesore të gurit të ndërtesës gotike, të vjetër 850 vjet, përfshirë dy kullat e saj, por maja dhe çatia u shembën. Nga ana tjetër, propozimi i Haradinajt po kritikohet nga përfaqësuesit e partive opozitare. Kreu i Partisë Social-Demokrate, njëherësh kryetar i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka shkruar në Facebook se mjetet do të duhej ndarë për rastet sociale në Kosovë. "Fondet të cilat qeveria i ka ndarë do të ishte mirë t'i ridestinojë për strehim dhe renovim të shtëpive të disa rasteve të rënda sociale. Së fundmi kemi pas disa djegie të shtëpive në disa komuna si pasojë e fatkeqësive dhe familjet nuk kanë mundësi me i riparuar. Për komunë të Prishtinës mund të ofrojmë informata", ka shkruar Ahmeti. Edhe deputeti i partisë tjetër opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku ka dalë kundër këtij vendimi. Ai ka shkruar në "Facebook", se Franca nuk ka nevojë për paratë e Kosovës. Kryeministri Haradinaj duke komentuar qëndrimet e përfaqësuesve të opozitës ka thënë se "të gjithë duhet të kenë kujdes për deklaratimet që bëjnë". "I dëgjoja disa deklarata të Shpendit dhe Lumirit. Ky është gjest nuk është që ne e renovojmë atë sepse ju e dini sa kushton renovimi i saj. Nuk e kanë mirë ata që mundohet të iu shëndoshin zemrat të varfërve. Në rast të caktuar edhe Franca i shëron njerëzit tanë. Sot në Francë strehohen dhjetëra mijëra qytetarë të vendit tonë", ka deklaruar Haradinaj në një prononim për media. Liderë botërorë dhe personalitete të njohura kanë shprehur vullnetin për të ndarë fonde që ndihmojnë në rindërtimin e katedrales. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, u zotua se do ta rindërtojë katedralen brenda pesë vjetësh, duke premtuar se "do të bëhet edhe më e bukur".



"The Independent": Thaçi po hetohet nga Gjykata Speciale

Presidenti kosovar: Krenar që kam qenë në krye të UÇK, s'duhet të përsëritet historia

"The Independent", gazeta prestigjioze britanike ka shkruar dje se Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka probleme personale, pasi Gjykata Speciale po heton disa nga udhëheqësit e UÇK-së, përfshirë edhe presidentin Thaçi. "Thaçi ka problemet e tij. Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhoma e Specializuar, që u vendosën në Hagë në 2017 janë duke i hetuar dyshimet për krime lufte ndaj disa prej figurave kryesore të UÇK-së, përfshirë edhe presidentin kosovar", shkruan prestigjiozja britanike. Thaçi insiston se nuk ka asgjë për t'u frikësuar, ndërsa thotë se është i gatshëm të presë çfarë do të sjellë e ardhmja. "Si gjithmonë, ne nuk do të ikim,



nuk do të turpërohem, do të përballemi me to dhe jam i sigurt se do ta përfundojmë me dinjitet dhe integritet", ka thënë Thaçi. Ai thotë se ka zëra që dëshirojnë që ta

HASHIM THAÇI

"Jam personalisht shumë krenar që kam qenë një nga liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithmonë do të ketë zëra që do të provojnë ta denigrojnë ose ta akuzojnë Kosovën, të përbuzin Kosovën dhe mua personalisht. Por kjo nuk do të thotë që unë kam ndonjë hezitim para asaj që mund të vijë. Unë besoj në drejtësi", ka thënë Thaçi për "The Independent".

njillosin Kosovën dhe atë personalisht. Megjithatë, ai thotë se nuk do të hezitojë t'i përgjigjet çdo gjëje që vjen. "Jam personalisht shumë krenar që kam qenë një nga liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithmonë do të ketë zëra që do të provojnë ta denigrojnë Kosovën ose ta akuzojnë Kosovën, të përbuzin Kosovën dhe mua personalisht. Por kjo nuk do të thotë që unë kam ndonjë hezitim para asaj që mund të vijë. Unë besoj në drejtësi. Çka nuk duhet të lejojmë në është përsëritja e historisë", ka thënë Thaçi për "The Independent".

Djegia e Notre Dame, ISIS mesazhe në rrjete sociale

Notre Dame nuk ishte e siguruar, ja kush kujdeset për shpenzimet

ISIS ka ndarë mesazhe në rrjete sociale pas djegies së Katedrales së 'Notre Dame'. ISIS ka publikuar një poster të katedrales në flakë krahas së cilës ndan edhe një mesazh. Në posterin e katedrales shkruhet: 'Paçi një ditë të mbarë'. "Është dita për t'i thënë lamtumirë këtij tempulli", shton ISIS. Nuk ka asnjë të dhënë se zjarri ishte i lidhur me terrorin, por fanatikë të ISIS kanë shijuar dëmtimin e katedrales 850-vjeçare, një simbol i civiliz-



Imit perëndimor, vetëm disa ditë para Pashkëve. Kombi francez, Europa dhe bota u

trondit nga ngjarja e paprecedentë e djegies së Katedrales, simbol kulturor në Paris. Prokurorët francezë kanë deklaruar se zjarri që ka rënë në ndërtesën e Notre Dame ka gjasa të jetë aksidental. Nga ana tjetër katedralja e Notre-Dame nuk ishte e siguruar, dhe ndaj duhet të jetë shteti francez pronar i strukturës, ai që duhet të kujdeset për restaurimin e strukturës që

u përfshi nga flakët të hënën në darkë. Shteti francez, në fakt, në mungesë është një siguruës i vetvetes për sa i përket ndërtesave fetare të së cilës është pronari. Kombi francez, Europa dhe bota u trondit nga ngjarja e paprecedentë e djegies së Katedrales, simbol kulturor në Paris. Prokurorët francezë kanë deklaruar se zjarri që ka rënë në ndërtesën e Notre Dame ka gjasa të jetë

aksidental. Më shumë se 400 zjarrfikës kanë marrë pjesë në shuarjen e flakëve në Katedrale. Ata punuan 14 orë rresht për të shuar flakët në Katedralen 8-shekullore. Prokurori publik Paris Remy Heitz tha se nuk ka asnjë shenjë të dukshme se kemi të bëjmë me zjarrvënie, shkruan "Reuters". Notre-Dame është monumenti historik më i vizituar në botë, çdo ditë ajo shihet nga rreth 13 milion turistë. Ajo u ndërtua mes viteve 1163 dhe 1344. Vetëm vitin e kaluar Kisha Katolike Franceze apelonte për të mbledhur fonde dhe për të filluar punën e restaurimit në strukturën e saj.

Familjet e pasura në Francë dhurojnë 800 milionë euro për restaurim

Notre-Dame, zjarri dyshohet nga ashensori, Macron: Do ta rindërtojmë brenda 5 vjetësh

Katedralja do të mbyllet për publikun për 5-6 vjet

Pas tri ditësh nga katas trofa kulturore e Notre Dame në Paris, dyshimet e para të hetuesve francezë bien mbi një aksident në ashensorin e kantierit të punimeve për mirëmbajtjen e Katedrales. Mediat franceze raportojnë se vatra e zjarrit mund të ketë qenë baza e shigjetës së shkruar, për t'u përhapur më pas në të gjithë catinë. Tashmë sfida është me kohën për ta rindërtuar në një kohë sa më të shpejtë. Rreth 800 milionë euro fonde janë mbledhur nga familjet e pasura dhe komant franceze. Në një fjalim emotiv përpara popullit, Presidenti Emmanuel Macron tha se solidariteti pas zjarrit në Notre Dame është prova se populli francez nuk ndalet kurrë. "Secili dha atë që mundi, secili në vendin e tij, në rolin e tij. Ky popull jemi ne, popull ndërtuesish. Kemi shumë për të rindërtuar. Po, ne do ta rindërtojmë Katedralen Notre-Dame edhe më të bukur, dhe dua që kjo të arrihet brenda 5 viteve, ne mund ta arrijmë". Synimi i Presidentit Macron është restaurimi i plotë i Notre-Dame brenda vitit 2024, kur Parisi do të presë Lojërat Olimpikë. Por një afat i tillë sipas ekspertëve duket i pamundur. Objektet me të cmuara të Katedrales, mrekullisht u shpëtuan flakëve. Ndër të është kryqi i altarit dhe statujat poshtë tij që datojnë në vitet 1700. Pas zjarrit që shkumboi pjesën më të madhe të objektit 850-vjeçar, e paprekur është thuasje e gjithë pjesa e altarit, statujat e Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit, si dhe xhamat shumëgjyresh të dritareve. Po ashtu pjesa më e madhe e ndenjësve të besimtarëve dhe vendet e ndezjes së qirinjve nuk është dëmtuar. Brenda në sallë kanë rënë mbetjet e çatisë që u shkruar krejtësisht. Janë shkruar trarët mbajtës prej dushku po ashtu edhe statujat që ndodheshin në çati. E gjithë struktura e gurit nuk është



dëmtuar ashtu si edhe dy kabanoret e famshme. Por mesa duket shkak për këtë fatkeqësi ka qenë pakujdesia gjatë punimeve të restaurimit. Mediat franceze shkruajnë se zjarri mund të jetë shkaktuar nga një shkëndijë e krijuar nga përdorimi i pajisjeve elektrike në majën e katedrales. Dyshohet që zjarri të ketë nisur pikërisht në atë pjesë të çatisë, për t'u përhapur më pas në gjithë ndërtesën. Kreu i prokurorisë së Parisit, Remi Hetiz tha se ka angazhuar një numër të madh prej 50 hetuesish për t'u marrë me atë që konsiderohet si çështje tepër komplekse. Sipas mediave franceze, tenderin prej 5.8 milionë eurosh për restaurimin e katedrales ikonë të Parisit e kishte fituar një firmë e vogël e quajtur

"Vëllezërit Le Bras". Drejtuesi i firmës është Julien Le Bras, 32-vjeç. Ai ishte ndër të parët që u morën në pyetje nga prokurorët për këtë ngjarje. Le Bras citohejt të jetë shprehur se në momentin kur shpërthyen flakët, në catinë e katedrales ndodheshin 12 punonjës të firmës së tij. Por ai shprehu garancinë se kushtet e sigurisë teknike nuk ishin shkelur. Presidenti francez Emmanuel Macron ndoqi nga afër të gjithë operacionin për shpëtimin e Katedrales. Bashkë me Notre Dame u dogj edhe një pjesë e jona, tha Macron. "Këtë Katedrale ne do ta rindërtojmë, të gjithë bashkë. Që nesër do të ndërmarrim një angazhim kombëtar, edhe përtej kufijve tanë, do t'i bëjmë thirrje talenteve më të

SHQIPERIA JEP PARA PËR NOTRE DAME
Qeveria shqiptare do të dhurojë 100 mijë euro për katedralen historike që u përfshi nga flakët dy ditë më parë. Ngjarja tronditi mbarë botën dhe disa biznesmenë kanë dhuruar deri tani miliona euro për rindërtimin e katedrales, së cilës i mbetën vetëm strukturat.

mëdhenj, që janë të shumtë. Ata do të vijnë të kontribojnë dhe ne do ta rindërtojmë Notre Dame, sepse këtë presin francezët, këtë meriton historia jonë". Notre Dame do të mbetet e mbyllur për publikun për të paktën 5-6 vite. Një gjë të tillë e bën me dije prifti dhe përgjegjësi i katedrales. Katedralja, ndër të tjera nuk ishte e siguruar ndaj edhe i takon Francës të marrë përsipër

shpenzimet. Ndërkohë ministri i Kulturës, Franc Riester ka garantuar që "shteti do bëjë atë që duhet". Ndër të tjera, kabanat e të gjithë katedraleve të Francës kumbuan të dje rreth orës 18:50, orë ku gjatë të hënës katedralja e Notre Dame u përfshi nga flakët. Një gjest solidariteti që kërkon të simbolizojë edhe bashkimin kombëtar përballë fatkeqësisë.

SHKURT
Kandidati i opozitës fiton Bashkinë e Stambollit

Efikrem Imamoglu u shpall fitues i zgjedhjeve bashkiakë në Stamboll nga autoriteti elektoral që i dorëzoi sot mandatin e kryetarit të bashkisë, njoftoi partia e tij. "Imamoglu mori këtë dokument, të dhënë nga Komiteti i Lartë Elektoral, pavarësisht kërkesës së paraqitur nga partia në pushtet e presidentit Recep Tayyip Erdogan për të zhvilluar një votim të ri me pretekstin se ai i 31 marsit ishte i mbushur me parregullsi", theksoi partia socialdemokrate, CHP.

Vetëvritet ish-presidenti Peruan, ja arsyt

Ish-presidenti i Perusë Alan Garcia vdiq nga një plagë vetëvrasëse në kokë ndërsa policia po përgatitej ta arrestonte atë për akuzat korruptive të mërkurën. Vdekja e tij u konfirmua nga Presidenti aktual Martin Vizcarra, i cili shprehu ngushëllimet e tij në Twitter. "I shkatërruar nga vdekja e ish-presidentit Alan Garcia, i dërgoj ngushëllimet e mia familjes dhe të dashurve të tij", shkroi Vizarra. Garcia u akuzua për korrupton, ndërsa vazhdimisht kishte mohuar akuzat e bëra kundër tij. Ai ishte 69 vjeç dhe ndërroi jetë në Lima, kryeqytet i vendit.

Aeroplani përplas me banesën, 6 të vdekur

Të paktën gjashtë persona kanë mbetur të vrarë në Kilin jugor, pasi një avion i vogël u rrezua në një lagje banimi të qytetit Puerto Montt. Pas incidentit, vendasi kërkuan mbyljen e aeroportit La Paloma. Avioni u rrezua në një shtëpi në Puerto Montt menjëherë pas ngritjes në orën 10:50, duke vrarë pesë pasagjerë dhe pilotin në bord, konfirmoi guvernatori i rajonit të Los Lagosit, Harry Jürgensen.

GODITET AKROPOLI NGA RRUFEJA, 4 TË PLAGOSUR NË GREQI

Ditën e djeshme një rrufe ka goditur hyrjen e Akropolisit, konkretisht pikëshitjen e biletave, duke e shkatërruar plotësisht kioskën e vogël dhe duke lënë të plagosur 2 punonjëse dhe 2 turistë, që në atë moment po blinin bileta për vizitën në monumentin e lashtë grek. Turistët u plagosën nga xhamat e thyer, ndërsa punonjëset nga forca e rrufesë. Athina ka disa ditë me shira të furishëm, madje breshër prej tri ditësh. Katër të plagosurit janë transportuar urgjentisht në spital, gjendja e tyre nuk konsiderohet serioze.



FOTOLAJM

Ku ka zë, s'është pa gjë! Një çift i ri në "show bizz"-in shqiptar

Anxhela Peristeri, në një histori dashurie me këngëtarin e njohur? Zbuloni të vërtetën

Ja detajet që u mbajtën larg nga publiku

Egla Xhemali

Ka ditë që po bën bujë lajmi për një histori dashurie në radhët e "show bizz"-it shqiptar. Ajo një bukuroshe, tejet e kujdesshme për të mbajtur larg gjithë vëmendjen e medias nga jeta e saj private, ndërsa ai i përkushtuar pas muzikës dhe kurrë i përfolur për lidhje me femra. Gjithçka zuri fill që kur dolën zërat për një bashkëpunim mes tyre. Këngëtarët Anxhela Peristeri dhe Mateus Frroku kanë realizuar një klip së bashku, ku duken shumë të afër me njëri-tjetrin dhe të gjithë aluduan se ky i fundit mund të ishte partneri i shumëpërfolur. Burime për "Gazeta Shqiptare" kanë bërë me dije se ka shkëndija dashurie mes dy artistëve, megjithatë asgjë nuk është pranuar nga ana e tyre. Kujtojmë se Anxhela është ngacmuar vazhdimisht për të dashurin e saj, ka që arritur ta mbajë larg botës rozë. Po këtë herë duket se është më e vështirë për të mbuluar këtë anë të jetës së saj, që Peristeri nuk do ta ndaj me askënd. Është momenti i të dyve dhe i suksesit që u solli "Muza ime". Nuk ka qenë i paktë interesi i gazetarëve për të zbuluar qoftë edhe ndonjë detaj të vogël nga historia që po gëlon këto kohë. E pyetur në të gjitha intervistat që ka dhënë, Peristeri ka preferuar të mos flasë dhe të vetmin sinjal e ka dhënë blogeri Olti Curri në emisionin e Rudinës në "Klan" TV, ku tha se zërat që qarkullojnë se këngëtarja është në një lidhje janë të vërteta. Megjithatë, vetë ajo nuk e pranoi asnjëherë publikisht. E ftuar në emisionin "Thumb", Anxhela sigurisht është pyetur edhe për jetën e saj private dhe mbi hamendësimet për një lidhje mes saj dhe Mateus Frrokut. Moderatorët e kanë ngacmuar lidhur me fizikun e saj, me që këngëtarja është dobësuar shumë, duke hedhur dyshimet se do kemi dasmë. "Prandaj i them të gjitha këto unë, që të mbuloj lidhjen me Mateusin", - i është përgjigjur këngëtarja. Më tej, dyshimet u shtuan edhe më tepër kur i pamë së bashku në TV "Klan". Teksa ishin të ftuar në emisionin "Be Caffè", Mateus i ka bërë të gjithë lësh me deklaratën e tij. "Me Anxhelën njihemi që kur kemi qenë fëmijë. Me Bujarin gjithë bashkëpunimi ishte kënaqësi. Më takon të zgjedh Anxhelën, jo vetëm për faktin që është një



mikeshë e vjetër, një vajzë fantastike, por është një dashuri e kohëve të fundit", ka thënë Mateus. Por, nuk ka pritur që të ndërhyjë dhe Anxhela duke thënë: "Ja këto thotë dhe i

ngatërron njerëzit". Tek "Zonë e Lirë" përpos bashkëpunimit mes tyre, Anxhela dhe Mateusi folën gjithashtu për ndryshim drastik në pamje. Ata folën gjatë për humbjen në

peshës. Anxhela tha se në tre muaj ka humbur 12 kilogramë duke bërë palestër dhe balet. Ndërkohë, Frroku tregoi se prej më shumë se një viti vrapon çdo ditë dhe se ka humbur mbi



30 kilogramë. Të jetë vallë rastësi ky ndryshim, apo një pakt i bërë mes tyre? Ajo që mund të themi me plot bindje është se ata duken mjaft të lumtur nëpër daljet televizive dhe e

plotësojnë më së miri njëri-tjetrin. Në horizont po përflakën shkëndijat e një ndjenje, që shpresojmë të jetë sa më e gjatë dhe pse jo të konfirmohet edhe publikisht.



I thanë "pse përdridhesh"? Alba Hoxha kthen përgjigjen epike

Ajo është një ndër personazhet më të përfolura në mediat rozë. Balerina e njohur dhe prezantuesja e motit ka "rrëmbyer" një pjesë të madhe të vëmendjes mediatike me lidhjen e saj të përfolur me Albi Nakon. Së fundmi, Alba Hoxha ka postuar një video duke bërë një kërcim sensual, ndërsa promovon cigaret duke uruar për një javë të mbarë, por ndjekësit kanë vërsuar me komente. "Një gjë nuk kuptoj unë, pse përdridhesh?", - shkruan një prej ndjekësve të shumtë të Albës në "Instagram". Por, bukuroshja seksi ka nxituar për t'i kthyer një përgjigje në lidhje me videon e postuar. "Kërcimi në gjak, ç'ti bësh", - shkruan balerina.



Po ju e kishit menduar? Miriam Cani zbulon pse nuk merr pjesë në festivale

Miriam Cani është një këngëtare shumë e dashur për publikun shqiptar. Ajo ka shumë vite në skenën muzikore, por prej kohësh nuk ka marrë pjesë në festivale. Pse vallë ka marrë këtë vendim? Miriam ka zbuluar për herë të parë arsyen në një intervistë për revistën "Class" dhe qenka më e thellë seç e kishim menduar. "Ka qenë gjithmonë një vendim i imi personal. Ideja e garës është diçka që më krijon shumë siklet, pasi gjatë rrugës mund të lindin shumë keqkuptime. Jam një njeri i ndjeshëm dhe mendoj se mund të mos e përjetoja mirë. Kam dashur të shprehem në mënyrë të drejtpërdrejtë te publiku me muzikën time apo me projektet e mia artistike", është shprehur këngëtarja.



Çfarë do të bëhet djali i Amit dhe Ermalit kur të rritet? Dëshira e tij do t'ju habitë

A marda Toska është një nga moderatoret më të njohura dhe më të dashura për publikun shqiptar, ashtu sikurse edhe bashkëshorti i saj, Ermal Mamaqi. Së fundmi Ami ka bërë një udhëtim në Budapest dhe falë postimeve në "Instastory" vihet re që nuk është vetëm, por shoqërohet nga vogëlushi i saj, Joeli. Si të gjithë fëmijët e tjerë, edhe Joeli ka një ëndërr në sirtar. Ami e ka zbuluar këtë ëndërr dhe nuk ka të bëjë as me televizionin, as me botën e biznesit, por është diçka e veçantë. Moderatorja në llogarinë e saj të "Instagram"-it ka postuar të birin në kabinën e një avioni, duke zbuluar se dëshira e për të ardhmen e Joelit është që të bëhet pilot.



Luana Vjollca paralajmëron diçka të madhe, ja për çfarë bëhet fjalë

Ditët e fundit Luana Vjollca nuk ndodhet në Shqipëri dhe këtë e kemi vënë re nga fotot e videot e shumta, të cilat i ka postuar në rrjetet sociale. Bukuroshja zbuloi se kishte shkuar në Turqi me stilisten e saj dhe të gjithë u bënë kuriozë me çfarë projekti po merrej atje Luana. Këngëtarja dhe moderatorja ditën e djeshme ka udhëtuar sërisht nga Turqia në Prishtinë dhe duket se po përgatitet për t'u rikthyer me hitin e radhës. "Direkt e në studio", shkruan Luana në postimin e saj të fundit. Vjollca nuk ka bërë të ditur asnjë detaj sa i përket këngës së re për të cilën po punon, megjithatë të gjithë fansat e saj duhet të jenë në pritje të një produksioni, që me gjasë do të kthehet në hit."



EKSPOZITA



FËMIJËT E LUFTËS

Vizatimet e vitit 1999

Fatmira Nikolli


Një shtëpi e verdhë e përpirë nga flakët ka zënë një fletë A4. Gjuhëzat e kuqe të zjarrit dhe shtëllungat e zeza duket se i kalojnë qoshet e fletës. Tri shtëpi të tjera janë shkrumbuar. Përmë nuk janë më jeshile dhe nuk në degët e tyre nuk sheh më asnjë gjethë. I ngajnë një dimri të ftohtë trupat e tharë. Çatitë e kullave kanë rënë dhe në vend të tyre shihet e zeza e boshit. Oborri i madh ka bar të djegur. Kanë lënë pas ëndrrat e thyera e janë nisur me rrobat e trupit pa e ditur se ku po shkojnë. Kanë ikur nga sytë këmbët vetëm për të ikur. Kosovë, 1999. Këto janë veçse dy prej vizatimeve të fëmijëve të luftës. Janë fëmijët që e i lanë shtëpitë në mesnatë, sepse fshati përpihej nga flakët dhe krismat dëgjohehin nga çdo anë. I zgjuan dhe i nxorën prej krevateve të ngrohta, e rrugës nga iknin prej aty, shihnin tmerrret e luftës. Flakë e zjarr, armë e krisma. Shkretimi i shtëpive linte pas jehonën e të qarave. Vizatojnë fytyra të përëltura, që të shohin në sy. Vizatojnë dhimbjen që njohën në moshë të njomë. Vizatojnë të vetmen botë që mbajnë mend, sepse e gjithë ç'dinin para saj është fshirë, siç fshin një dhembje e madhe çdo gëzim të vogël. Kamionë të mbushur me njerëz ecnin rrugëve si të çmendur. Të gjithë iknin, rrekeshin t'i iknin vdekjes. Kërkon vetëm pak centimetra vend në makinat që niseshin rrugëve të zbrazëta. Ekzistonte frika e patrullave, ekzistonte dhe frika e kurtheve. Fëmijët nuk mund të luanin më, ata u bënë "ushtarë" të një loje më të madhe, duhej t'i shpëtonin vdekjes.

Siç shihet nga vizatimet, gjurmët e traumës psikologjike shprehen qartazi në shumë nga punimet e para të vogëlshme, traumë, e cila gradualisht u arrit të mposhtej duke u zëvendësuar me vizatime gjithmonë e më optimiste, me ëndrrën për një të ardhme në paqe dhe për një rikthim sa më të shpejtë shtëpitë e tyre në Kosovë.

Pas vizatimeve të maktheve që kishin parë, fëmijët nisën të vizatonin shtëpitë e tyre të reja, fusha me lule, një urë kryelartë pas të cilës naltohej një shtëpi e re dhe deti, deti me valë të paqta që i dorëzohej pushtetit të diellit.

20 vjet më pas disa prej atyre fëmijëve janë në Tiranë e për t'u përballur më të shkuarën.

Gjatë periudhës 1998-1999 dhuna dhe terrori serb detyroi mbi 600 mijë kosovarë të largohen nga trojet e tyre drejt Shqipërisë. Mikpritja dhe ngrohtësia vëllazërore e pop-



ullit shqiptar e lehtësoi sadopak dhimbjen dhe traumën që ata po përjetonin.

Në këtë emergjence njerëzore, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Qendrën e Traumës dhe Torturës (QSHDNJ/QTT) u angazhuan me programe në fushën e trajtimit psikologjik dhe mjekësor në Tiranë dhe Durrës. Gjithashtu, u hapen 36 shkolla verore/argëtuese, ku mësues dhe ekspertë të edukimit, ven-

Çelet ekspozita "Një rrugëtim i vështirë- 20 vjet pas"

das dhe kosovarë u angazhuan për rehabilitimin e një numri të madh të fëmijëve të traumatizuar kosovarë. Numri i personave që përfituan nga këto shërbime arrin afërsisht në 40 mijë.

20 vite më pas, një ekspozitë në Qendrën për Hapje e Dialog sjell përvojat e fëmijëve.

Ekspozita është një bashkëpunim mes COD dhe QSHDNJ (Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut). Për here të parë këto punime u ekspozuan në Prishtinë, në gusht 1999, menjëherë pas çlirimit.

FEMIJET

Nga gjithsej 11.840 të vrarë shqiptarë në Kosovë gjatë luftës së fundit që ka përfshirë periudhën mars 1998 qershor 1999 në mesin e






COD ka kënaqësinë t'ju ftojë në hapjen e ekspozitës

NJË RRUËTIM I VËSHITËRË - 20 VJET PAS

Ekspozitë me punime të fëmijëve kosovarë gjatë eksodit në Shqipëri 1998-1999

HAPJA: E ENJTE, 18 PRILL 2019, ORA 18.00

Kryeministria, Blvd "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1, Tiranë, 1000, Shqipëri
Lutemi konfirmim: cod@kryeministria.al

LIRI DAVARSI



tyre llogariten të vrarë 1.392 fëmijë apo 11% nga viktimat totale kanë qenë fëmijë. Edhe me i dhimbshëm rezultoi fakti se në mesin e 1.392 fëmijëve të vrarë 296 prej tyre kanë qenë nën moshën 5 vjeç.

Këto shifra kanë dalë nga historiani kosovar Jusuf Osmani, i cili për vite të tera pas luftës ka hulumtuar dhe mbledhur të dhëna në lidhje me bilancin e dëmeve njerëzore dhe materiale që i janë shkakuar Kosovës nga Serbia, me fokus periudha e luftës. Historiani Osmani gjitha të gjeturat e tij i ka mbledhur në dy libra të veçanta ilustruar me fakte dhe të dhëna që pasqyrojnë pasojat shumëdimensionale që ka përjetuar popullata në Kosovë. "Në shumë vendbanime është hasur vrasja e fëmijëve në dje, pastaj vrasja në duart e nënës, vrasja dhe pastaj djegia e tyre, në vendbanime ku popullata është strehuar nëpër male janë hasur raste të masakrimit për së gjalli të fëmijëve, pastaj vrasja e nënave shtatzënë" thotë autori Osmani në librin e tij "Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë 1998 - 1999".

HISTORI

Shpata (shqiptare) e Napoleonit, që ju dhurua Hrushovit

Fatmira Nikolli

Mes shumë e shumë fotove që ekspozohen te "Dinasia Marubi: njëqind vite të studios fotografike shqiptare" kurrar nga Kim Knoppers në Muzen Marubi është edhe një që shërben si dëshmi historike. Në foton qëndrore shihet Prenk Bib Doda (1858-1919), një ndër personalitetet më të rëndësishme të historisë politike shqiptare, princ i Mirditës, ndër drejtuesit kryesorë të Lidhjes së Prizrenit, komandant i forcave për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, shërbeu dy herë si zëvendëskryeministër - edhe në të parën qeveri shqiptare të Ismail Qemalit - dhe dy herë si ministër i Punëve Botërore.

Në fotografinë e shkrepur në studion e Pietro Marubbi-t, ai pozon me krenari me kostum kombëtar si dhe me shpatën e të atit, Bibë Dodës, dhuratë e Napoleonit III e cila gjatë regjimit komunist, mendohet t'i jetë dhuruar Nikita Hrushovit gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 1959. Imazhi është publikuar me këtë sqarim nga vetë muzeu. Ndonëse Marubët kishin një aktivitet tregtar, kjo nuk i ndaloj ata në asnjë moment të eksperimentonin me teknika të reja. Pietro realizoi kolazhe duke pretrë fragmente nga fotografi të ndryshme e duke i rifotografuar si një imazh i vetëm. Ai eksperimentoi edhe me fotografinë stereoskopike, e cila u perfeksionua më tej nga Kel Marubi, por nuk gjeti shumë përdorim. Gega, i fundit i dinastisë, përdori për herë të parë në Shqipëri, fotografinë me infra të kuqe.

KOHË ARMËSH

Por, nuk është vetëm fotografi e princit që ka në fokus ose ruan imazhin e një drejtuesi më armë në atë kohë. Një tjetër imazh që është pjesë e ekspozitës është një fotografi e shkrepur në studion e Kel Marubit, atë të dorëzimit të armëve, në të cilën shohim kapiten Mark Rakën - i dyti nga e majta me dekretin në dorë - pas miratimit të ligjit për dorëzimin e armëve nga qeveria e vitit 1922 dhe bajraktarin e Shalës, Lush Prelën, me veshje malësore, i cili tekta lexon dekretin, bën të dorëzojë armën. Ky imazh, një ndër më të njohurit e arkivës Marubi, për momentin e rëndësishëm historik që paraqet si dhe vlerat artistike e kulturore që mbart, është qëndror në njërin nga seksionet e ekspozitës. Tri breza fotografësh kanë bërë portrete në studio të një shumëllojshmërie të gjerë njerëzish, duke filluar nga borgjezia urbane, te barinjët, imazhe nga koha e Perandorisë Osmane dhe nga Mbreti Zog, te kriminelët, aktorët e artistët e famshëm dhe piktorët.

Në vijim të punës për arkivimin, katalogimin dhe dixhitalizimin e arkivës fo-

Dëshmia e një fotografie, nga selia e princit shqiptar në Moskë



Dorëzimi i armëve 22 korrik 1922

tografike të Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi", databaza 'online' e muzeut është pasuruar me 10000 imazhe të reja të periudhës ndërmjet viteve 1860-1950 të koleksionit të Marubëve.

Kjo bëhet e mundur edhe në kuadër të regjistrimit të të dhënave të fotografive në bazën e të dhënave shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore" pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, me qëllimin dokumentimin, ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe historisë së Shqipërisë përmes fotografive 'on-

line'. Ekspozita e hapur më parë në FOAM Amsterdam i drejtohej një publiku të huaj e njëkohësisht edhe vizitorëve të shumtë ndërkombëtarë që mirëpret ky muze çdo vit. Ekspozita kishte karakter njohës jo vetëm për fotografinë, por edhe për historinë e Shqipërisë të parë përmes tri gjeneratave të Marubëve ndërsa ajo e sapo hapur në muzeun tonë, është një prezantim i punës së studios Marubi, i imazheve që na sjellin Pietro, Keli e Gega. Koleksioni i tyre me mbi 150,000 xhama negativë paraqet interes nga pikëpamja historike, sociologjike, kultur-



Shpata që ju dhurua Hrushovit

ore, antropologjike dhe artistike. Në të zbulojmë ngjarjet, ritualet shoqërore, kostumet folklorike, portretet në studio e jashtë saj përmes të cilëve lexohet historia e vendit tonë, por njëkohësisht edhe zhvillimet teknike të procesit fotografik. Çdo vit

muzeu organizon ekspozita që risjellin në vëmendje pasurinë arkivore të fondit muzeal. Fondi i arkivës "Marubi" është akoma i padigjitalizuar e si rezultat i kësaj, edhe për ne, arkiva është një zbulim i vazhdueshëm.

TË KESH MIK NJERIUN A QENIN, NË TEATËR "HISTORIA E KOPSHTIT ZOOLOGJIK"

Duke filluar nga datat 19 prill ora 20:00 në sallën "Goethe" të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" do të ngjitet premierë shfaqja "Historia e kopshtit zoologjik". Është një vepër e shkruar nga Edward Albee. Premiera e kësaj veprë daton në vitin 1958. Subjekti është i thjeshtë në dukje. Xherri do të hyjë në bisedë me Piterin, një person të gjetur rastësisht, në një kënd të "Central Park" në Nju Jork, pranë kopshtit zoologjik. Dialogu fillon thjeshtë, pasi Piter "vendos" t'i kushtojë vëmendje! Vetëm kjo vëmendje i duhet Xherrit për të përshkruar jetën e tij të thjeshtë, larg "rehatisë" së Piterit. Me klorit sarkastik dhe ironik, ai përshkruan gjithë personat, me të cilët jeta e ka përplasur pa mëshirë, duke kulmuar në marrëdhënien e koklavitur me një qen. A është më lehtë të miqësohemi me një qen, se me një njeri?! Si përballimi me të tjerët në mungesë të dëshirës për të komunikuar?! Sa degojmë të tjerët? Dhe të mendosh, që veshët nuk kanë "kapak"... Çfarë jemi të gatshëm për të bërë, vetëm për plotësuar nevojën tonë, si humanë, për të komunikuar?! Duke u nisur nga ky këndvështrim, dramaturgu na jep një fund të papritur të veprës.

POETËT E PRANVERËS, KONKURS NË RRJETET SOCIALE

Në prag të Ditës Ndërkombëtare të Librit, Ministria e Kulturës shpall konkursin e Poetëve të Pranverës. Më tej kjo nisimë ka për qëllim promovimin e poetëve të rinj, edhe konkursi do të zhvillohet përmes rrjeteve sociale. MK shënon se të gjithë duhet të ndihen të lirë të marrin pjesë në këtë garë, duke postuar një apo dy nga poezitë tuaja më të bukura. "Mos kini 'frikë' nga juritë, juria do jeni vetë ju! Poezia që merr më shumë pëlqime do të shpallet fituese në 23 prill, në festën e Librit", përfundon njoftimi.



Dje në "Deutsche Welle"

Notre-Dame do të ringrihet

Nga Rick Fulker

(vijon nga faqja 1)

... në 11 shtator 2001, ato janë gdhendur që tani në kujtesën kolektive.

A mund të ketë një ngjarje tjetër, që do t'u shkaktoje me shumë dhimbje besimtarëve, të interesuarve për artin dhe turistëve? Katedralja e Notre Dame është simbol i ndërtimit të stilit gotik, monumenti më i vizituar i Evropës, një vepër arkitekturore, e cila e prej gati 900 vjetësh e ka vendin në zemrën e Parisit dhe ka një peshë të pakrahasueshme si për të krishterët, ashtu edhe për artin dhe të interesuarit për artin nësoj. Dhe sërish Parisi! Pas atentateve të tmerrshme terroriste të "Charlie Hebdo"-ë dhe të "Bataclan"-it, ky lajm i trishtë e godet Parisin në palcë dhe tregon sa i hollë dhe i prishshëm është vërniku i civilizimit. Sa plagë duhet të marrë dhe duhet të durojë ende ky qytet krenar?

SOLIDARITET DHE KËSHILLA

Menjëherë politikanët kryesorë të botës i drejtuan Francës fjalë të tronditjes dhe të solidaritetit. Presidenti francez, Emmanuel Macron, e quajti Notre Dame "epiqendrën e jetës sonë" dhe shprehu dhimbjen kolektive të të gjithë francezëve: "Këtu digjet edhe një pjesë e jona". Edhe vetë Presidenti i SHBA, për të cilin nuk kanë



dyshimin se nderon civilizimin e vjetër, u ankua për shkatërrimin e njërit "prej thesareve më të mëdha të botës" dhe "një pjesë të kulturës sonë".

REHABILITIM = SHKATËRRIM?

Për dy shekuj me radhë e ndër-tuan Katedralen. Që prej vitit 1345, ajo qëndron e përfunduar në Ile de la Cité të Parisit. Çfarë nuk ka kaluar kjo "zonjë e vjetër"? Luigj XIV iu duk i vjetruar interiori, ai e transformoi krejtësisht. Në Rev-

olucionin Francez kisha u përd-tuan, u hoqën figurat e gurta dhe ndërtesa u përdor si depo vere. Katedralja mbijetoi edhe dy luftëra botërore: përshtypja që u krijua ishte se ajo ajo duhet të qëndronte aty përjetësisht. Por në fakt

ndërtesa kishte nevojë të madhe për rinovim. Shkaku i flakëve nuk është sqaruar përfundimisht, ekspertët aktualisht megjithatë nuk besojnë se ajo që ndodhi që shkatërrim i qëllimshëm ose atentat, por një aksident, i cili ka të bëjë me punimet e rehabilitimit. Po të dalë e saktë kjo, atëherë këtu do të kishim një tragjikë të veçantë, thuhet paradoksale: në përpjekje për të shpëtuar strukturën e vjetër të katedrales, ajo u shkatërrua. Takimi i materialit të vjetër me teknikën e re pati pasojë shkatërrimtare.

PARISI PA NOTRE-DAME? NONI

Ndoshta dikur do të dihet më shumë për rrjedhën e ngjarjeve. Për momentin thjesht nuk të besohet ajo që ka ndodhur: Po Parisi pa Notre-Dame? I apërftueshëm. Pa kaluar 24 orë nga shpërthimi i zjarrit, qeveria polake dhe gjermane premtuan ndihmë për rindërtimin. Dy familje miliardere të Parisit vunë në dispozicion 300 milionë euro për restaurimin. Qyteti i Parisit premtoi 50 milionë euro dhe një konferencë për koordinimin e donacioneve ndërkombëtare. Pas zjarrit shkatërrimtar, muret e jashtme dhe kulat ende qëndrojnë, disa thesare artistike dhe organoja e famshme e viteve 1730, me sa duket u arritën të shpëtohen. Një gjë është e sigurt që tani: edhe nëse rruga do të jetë e gjatë dhe ndoshta do të kërkojë dekada, Notre-Dame do të ngrihet sërish në këmbë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinioni *i* Ditës

Mohuesit e krimeve

Nga Arben Idrizi

(vijon nga faqja 1)

... Sigurisht, rastet më shokuese janë ato të Holokaustit, Masakrës së Nankinit, gjenocidit ndaj armenëve, masakrës së Srebrenicës.

Pra, edhe kur ka një konsensus të përgjithshëm për të vërtetën, të mbështetur edhe nga proceset e panumërta gjyqësore, prapëseprapë ka zëra që i mohojnë. Për rrjedhojë, është edhe më e vështirë nëse autori i krimin nuk është përballur asnjëherë me asnjë lloj përgjegjësie.

Zyrtarë politikë e ushtarakë serbë janë përballur me drejtësinë në Gjykatën e Hagës, për krimet e kryera nga forcat serbe në Kosovë. Por, brenda në Kosovë gjykimet e krimeve të luftës kanë qenë përgjegjësi vetëm e misioneve të ndryshme të vendosura këtu dhe në përgjithësi nuk ka pasur gjykime për shumicën e masakrave të kryera nga forcat serbe, as për vrasjet dhe zhdukjet e qytetarëve serbë të kryera nga UÇK.

Ndërsa në Serbi ekziston gjykatë për krimet e luftës, ka dënuar disa persona, por në të vërtetë e gjitha është një farsë. Pikërisht një gjykatë e tillë e mohon pikërisht masakrën e Reçakut, njërin prej krimeve më të rënda.

Nëse - qoftë edhe vetëm si farsë - ajo gjykatë serbe do të kishte iniciuar një proces gjyqësor, thjesht iniciuar, mohimi i krimin do të kishte me qenë më i vështirë. Ngase atëherë, cilitdo që do të merrte guximin ta mohonte, do të mund t'i thuhej se ka një proces të hapur për atë krim. Nëse do të ishte dënuar ndonjëri, qoftë edhe me vetëm një muaj burg, çdonjërit mohues do të mund t'i thuhej se ka një të dënuar me një dënim prej një muaj burg, që në rrethana të tjera, të seriozitetit dhe korrektesisë, do të mund të ishte dënim i përjetshëm.

Dhe, nga ana tjetër, nëse edhe në Kosovë do të ishte iniciuar, nga misionet ndërkombëtare të drejtësisë të vendosura këtu, një proces gjyqësor, në këtë rast, organet për-



katëse do ta kishin më të lehtë të përballen me një mohues të një krimi, plagët e të cilit ende rëndojnë mbi tërë shoqërinë.

Por, duke qenë gjendja si është, çka mund të bëhet?

Nuk është problem që zgjidhet me kërcënime, fytyje e sharje. Sepse këto, në të vërtetë, nuk e zbusin as dhimbjen, ashtu siç nuk çojnë domosdoshmërisht dhe pashmangshmërisht tek e vërteta.

Të të dy shoqëritë ka tendencë të përgjithshme të mohimit të krimeve. Kur jemi të mbështetur për muri, i arsyetojmë ato krime ose sajmë teori konspiracionesh që mendja e shëndoshë nuk i kap dot.

Të paktë janë personat, institucionet, intelektualët që i pranojnë, denoncojnë dhe dënojnë krimet, kudo që të jenë kryer, nga kushdo

që të jenë kryer. Sigurisht, punën më të madhe, më të frytshme dhe më të guximshme e ka bërë Fondi për të Drejtën Humanitare.

Për shembull, pas kallëzimit penal të ngritur nga FDH, në maj në maj të vitit 2008, ndaj 11 pjesëtarëve të brigadës 549 nën dyshimin se kanë kryer krim në Tërnjë, dje Departamenti i veçantë për krimet e luftës i Gjykatës së Lartë të Beogradit i ka dënuar me 15 vjet burg Rajko Kozlin, ish- pjesëtar i Ushtisë Jugosllave, për vrasjen e 15 dhe plagosjen e dy civilëve shqiptarë në Tërnjë, afër Suharekës, në mars të vitit 1999.

Besoj se jemi të gjithë të një mendjeje se ai që deri dhe mund ta mohonte këtë krim, sot do ta ketë më të vështirë ta bëjë këtë. Do të

matej mirë para se ta bënte.

Dhe, në të njëjtën kohë, nëse do të kishte pasur një gjykim për vrasjen e 14 bujqve serbë në Grackë të Vjetër të Lipjanit, apo për vrasjet e serbëve, romëve dhe shqiptarëve në vende të tjera - ai që i mohon, ose i arsyeton, do të ishte matur mirë para se ta bënte këtë herën tjetër. Por, deri sa (nëse do) të ndodhë ai gjykim, ne vazhdojmë ta bëjmë, pa problem.

Çka desha të them është se duhet shumica ta ndiejë neverinin ndaj krimeve dhe ta shprehë pakënaqësinë, me të gjitha forcat. Në atë rast, pakica që mohon, do të ishte pakica që nuk përfaqëson dhe nuk ndikon. Në gjendjen ku jemi, shumica nuk e ndien neverinin ndaj krimin as nuk e shprehë, përkundrazi.

Gazeta Express

HOROSKOPI

DASHI

Detyrimet dhe përgjegjësitë familjare do të marrin një pjesë të madhe të ditës tuaj sot, por mos u shqetësoni. Njërit që ju duan ju vlerësonin pa kushte. Sa i përket çështjeve romantike, gjërat do të marrin kthesë pozitive.

DEMI

Kjo ditë do të jetë pjesërisht me re, por duhet të përpigjeni ta mendoni atë si pjesërisht me diell në mënyrë që të jeni më optimist. Në vendin e punës keni nevojë për një impuls të ri.

BINJAKET

Dikush të cilin e keni menduar gjithmonë si të shtrënguar me paratë, në fakt, do të dëshmojë se është shumë bujar me ju. Sa i përket profesionit, mund të përballeni me disa sfida që nuk janë të pakalueshme.

GAFORJA

Nëse nuk doni të dyfishoni ngarkesën e punës sot, atëherë do t'ju duhet të trajtoni çdo çështje në momentin që ajo del. Mos lini asgjë për në momentin e fundit, ndryshe përveç punës do të akumuloni edhe shumë stres.

LUANI

Të kesh një sjellje të kontrolluar do të jetë e rëndësishme sot, kur një situatë të bëhet më emocionale sesa e parashikonit. Tregohuni i arsyeshëm dhe, gjithashtu, jepni shembullin pozitiv për njëri-tjetrin.

VIRGJERESHA

Një ditë e ngarkuar me punë parashikohet të jetë kjo e sotmja, por me shumë angazhim dhe më pak stres do t'ia dilni të mbaroni gjithçka me sukses. Këshilloheni të mendoni më shumë për jetën private.

PESHORJA

Përpiguni të jeni më i kujdesshëm me paratë sot. Nuk favorizoheni për investimet të paprojektuara mirë, por njëkohësisht mos ia kurseni vetes kënaqësitë e jetës. Në dashuri mund të keni nevojë për më shumë fat.

AKREPI

Sot mund të merrni disa komplimente sa i përket pamjet tuaj. Shrytëzoheni për mirë sharmin që ju rrethon si pasojë e aspektit planetar. Në dashuri, njërit të cilët më parë nuk ju kishin vlerësuar, sot do t'ju kushtojnë të gjithë vëmendjen.

SHIGJETARI

Lajme të mira parashikohen për personat e dashuruar. Nëse po planifikoni ndonjë udhëtim, gjasat janë që udhëtimi të jetë mjaft emocionues. Në vendin e punës jo gjithçka po ecën me ritmin e duhur.

BRICJAPI

Sot nuk është një ditë që të hezitoni kur të shihni diçka të gabuar. Sa më shpejt që të reagoni, aq më mirë do të jetë. Sa i përket një investimi, gjasat janë që të jetë i suksesshëm.

UJORI

Një shpërthim emocional mund t'ju shqetësojë më shumë nga sa e prisnit. Duke folur me qetësi do të shikoni se gjithçka do të zgjidhet. Në dashuri, shmangni debatet e kota të nxitura nga xhelozia.

PESHQIT

Sot do të keni nevojë që të kaloni më shumë kohë vetëm Periudha e reflektimit nuk bëhet në ambiente të zhurmshme. Sa i përket profesionit, duket se keni nevojë për ndryshime dhe impulse të reja.

PRESIDENTI I FSHF-së



Gjatë prezantimit të trajnerit të ri, Armand Duka ka zbuluar prapaskanat e kësaj tratative, e cila ka nisur në Shkodër dhe është pasuar nga një takim të dytë në Bolonja: "Mendoj se kemi bërë më të mirën. Pasi të përfundojë, do të shohim nëse kemi bërë mirë apo keq. Një trajner me eksperi-

Duka: U takuam në Shkodër, e mbyllëm në Bolonja

encë, besoj se do të japë atë që ka nevojë ekipi ynë. Kemi lojtarë cilësorë. Kanë nevojë për një ekspertizë, për një motiv dhe besoj se Reja i ka cilësitë për ta bërë këtë". E vërta e takimit në Shkodër? "Jemi takuar pas ndeshjes,

patjetër që i kam kërkuar një opinion, 'e njihni Shqipërinë, e keni parë më parë'. Pa e menduar se do të jetë ai, trajneri i Shqipërisë. Pastaj kemi folur në telefon, jemi takuar në Bolonja. Gjëja që më ka bindur më shumë dhe që

besoj se është zgjidhja e duhur është eksperiencia e madhe dhe mënyra si i ka trajtuar problemet. Kishte informacion për të gjithë futbollistët që janë jo vetëm në Kombëtare, por edhe rreth e rrotull", theksoi ndër të tjera presidenti Duka.

Italiani ka firmosur deri në nëntor, më pas do të ulet sërish të bisedojë me Dukën



Jeton Selimi

Edi Reja është zyrtarisht trajneri i ri i Kombëtares, i cili ka firmosur një kontratë deri në nëntor, me opsion rinovimi. Në fjalën e tij, tekniku italian theksoi se në karrierën e tij ka firmosur gjithnjë kontrata të shkurta: "Uroj të shkojë gjithçka mirë, edhe pse me shtypin është pak e vështirë, por unë jam i disponueshëm të kem marrëdhënie të mira. Dua të falënderoj presidentin Duka, i cili besoi tek unë. Kemi folur bashkë edhe pas ndeshjes me Turqinë, ku unë isha për të parë lojtarët të ndryshëm. Nuk ishte një ndeshje e mirë, skuadra pati vështirësi. Folëm sërish me presidentin Duka dhe arritëm akordin. Kontrata ime është deri në nëntor. Të mbarojmë këtë fazë të parë dhe më pas të shohim se si do të vazhdojmë. Unë firmos zakonisht kontrata njëvjeçare, sepse janë rezultatet që vendosin. Kisha mundësi të punoja në Itali, por kisha dëshirë të drejtoja një kombëtare dhe ja ku erdhi rasti të drejtoj Shqipërinë. Dua të përshëndes

Reja: Nuk kam ardhur për para, doja të drejtoja një Kombëtare

Prezantohet trajneri: Këtu, për të bërë mirë




Panuçin për punën që ka bërë, më vjen keq që u largua. Duka më telefonoi pas shkarkimit të Panuçit dhe jam kërenar për këtë ofertë". Trajneri i ri i Kombëtares së Shqipërisë ka ndërhyrë në

pyetjen që gazetarët i drejtuan presidentin Armand Duka në lidhje me termat financiarë të kontratës. "Dua të sqaroj diçka. Kam shumë vite që jam trajner dhe paratë në këtë rast kalojnë

në plan të dytë. E rëndësishme është të ndërtojmë një grup që të identifikojë kombin", ka bërë të ditur Reja. Trajneri zbuloi se ka firmosur deri në nëntor të këtij viti me opsion rinovimi,

në bazë të arritjeve sportive të skuadrës kuqezi. Trajneri i ri ka shpjeguar dhe filozofinë e tij të lojës, atë që kërkon nga përfaqësuesja shqiptare, por fillimisht kërkon pak më shumë kohë për t'u njohur me ekipin: "Mua më pëlqen të impostoj skuadra me logjikë, kam qejf skuadrat agresive, por jo gjithmonë. Kjo është një punë që duhet ta bëj në pak kohë. Varet nga shumë situata, varet nga grupi, çfarë stimujsh mund të ketë lojtari. Nga vitet që kam gjatë eksperiencës sime, arrij të kuptoj dhe t'u hyjë në kokë lojtarëve. Në këtë punë, kushdo që punon me kombëtare ngaqë nuk ka gjithë kohën lojtarët, duhet të hyjë në mënyrë sa më të shpejtë në sintoni me ta. Më lini pak kohë të njoh skuadrën dhe të shohim rezultatet".

GARDIANI KUQEZI



Reja e "përkëdheli" në konferencë, Strakosha pret penallti

Lacio ka fituar ndaj Udinezes 2-0, falë golave të Kaisedos në minutën e 21-të dhe autogolit të Sandros në të 24-tën, në sfidën e prapambetur mes Lacios dhe Udinezes, që mbylli dje javën e 38-të të kampionatit italian. Por, pavarësisht formës së mirë të sulmuesve, është edhe njëherë portieri Tomas Strakosha, që ngjitet në katedër dhe bëhet protagonist në minutën e 52-të, kur ndal penalltinë e gjuajtur nga De Pol, duke ruajtur epërsinë e çmuar të kryeqytetasve, të cilët nëse sigurojnë këtë trepikësh, mbajnë gjallë ëndrrat për një vend në Champions League sezonin e ardhshëm.

ÇËSHTJA E NXEHTË

Tomas Strakosha dhe Ermir Lenjani ishin dy çështjet më të nxehta, që u krijuan nën menaxhimin e Kristian Panuçit. Portieri u la jashtë për arsye vonese, ndërsa i dyti reagoi se nuk do të vishej më kuqezi sa kohë të ishte Panuçi trajner. Gjatë konferencës për shtyp të prezantimit të trajnerit të ri të Shqipërisë, Edi Reja, "Balkan Web" u fokusua në kjo çështje, duke pyetur si trajnerin e ri, ashtu edhe presidentin Armand Duka. Reja u pyet sesi e

Reja dhe Duka në unison, duan Lenjanin në Kombëtare



gjykon këtë qëndrim të lojtarit, pasi një sjellje e tillë mund të jetë problematike në të ardhmen. "Ai duhet të shohë Kombëtaren, jo për trajnerin, por për vet-

en dhe federatën. Por, ka bërë 6-7 gola këtë sezon dhe është një lojtar me vlera të mëdha. Është më shumë ofensiv dhe disi më pak defensiv. Të gjithë lojtarët duhen vlerësuar dhe të shikojmë në çfarë gjendje janë, më pas do bëjmë grumbullimin", u shpreh trajneri 73-vjeçar. Ndërsa për presidentin Duka, pyetja ishte në një tjetër spektër, pasi pak vite më parë, nën drejtimin e De Biazit, u vendos se nuk


do të grumbullohej më kurrë me Kombëtaren një lojtar që e refuzon atë. "Në 2 këndvështrime nuk do të t'i thosha 'jo' Lenjanit, sepse më ka gëzuar me kontributin e tij në Kombëtare prej më shumë se 7-8 vitesh. Do ta kushtëzoja shumë një trajner të ri po t'i thosha që s'do të marrësh këtë. Pavarësisht se çfarë thuhet, Lenjanit i ka shkuar ftesa me shumë vonesë, të përcaktuara nga rregulloret e FIFA-s", deklaroi Duka, duke "justifikuar" një farë mënyre shpërthimin e anësorit të Sionit një muaj më parë.

NUK KA ASNJË RIVAL

"Topi i Artë", Leo Mesi drejt trofeut të gjashtë

Topi i Artë" i këtij viti duket se po shkon në drejtim të Argentinës, me Leo Mesin që ka hapur sinjalin e parakalimit ndaj rivalëve të tjerë. Me Cristiano Ronaldon, rivalin e tij më të madh dhe me Luka Modriç, fituesin në fuqi, të dy të eliminuar nga Championsi. Ylli i Barcelonës nuk ka asnjë rival potencial për t'i hequr nga duart trofeu i gjashtë në karrierë. Me dygolëshin e shënuar në portën e Mançester Junajtidit dhe me një bilanc personal prej 10 golash në këtë edicion të Championsit, ai i sheh të gjithë kundërshtarët nga lart. Për momentin, golat në total në Champions janë 110, 16 më pak sesa portugezi, por argentinasi ka të paktën edhe dy ndeshje të tjera në dispozicion për ta pasuruar edhe më shumë rekordin personal. Gjithashtu, Leo Mesi po bëhet gati të festojë tituj të shumtë. Titullin në Spanjë e ka thuar në xhep, sikundër dhe "Këpuçën e Artë" për herë të nëntë. Në Europë ende asgjë nuk ka përfunduar, por pavarësisht kësaj, Mesi ka zgjatur duart drejt trofeut të gjashtë të "Topit të Artë".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë një arkë.
8. Fillojnë ndeshjen
9. Paul që këndon Diana.
10. Spanja që këndon en Itali.
13. Fillojnë lojën.
14. Gjysmë tepsie
17. Mund të jenë ekspres.
18. Qe babai i mjekësisë.
21. Eshhtë si ballon.
22. Lind një në kokë.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Një pjesë e edukatës.
27. Inicialet e Asimov.
28. Eshhtë e vrara në kufje.
30. Iglit te Lazio.
31. Inicialet e Redford.
33. Mbetet në fund.

34. Pak analogji.
35. Eshhtë vdekje e autorizuar.
39. Një numër femrash.
42. Në krye të modernistëve.
43. Kërkojnë talent.
44. Mbetet në fund.
45. U vra me një grushgtn nga Odiseu
47. Bëhet në start.
49. Catherine aktore.
50. Ishte babai i Odiseut

VERTIKAL

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një...FIAT.
3. Mbyllin një hark.
4. Eshhtë si sarkazmë.
5. Fillojnë ideologjinë.
6. Ushtrohet me cd false.
7. Në këtë moment.
8. King Cole i muzikës.
11. Janë si cilësi.
12. Fillojnë nazet.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. Janë binarët.
18. Nënkuqtojnë edhe pranga.
19. Aktet pa kufij.
20. I takojnë fituesit.
21. Quinn aktor.
22. Pak inekzistente.
23. Fillojnë dobët.
24. Rrjeshtohen në kuvertë.
29. Eshhtë divorci.
32. Një pije piratësh.
33. Zanore për perime.
36. Një peshk i rëndë.
37. Enti amerikan i hapësirës.
38. Yll anglez.
40. Gripi paa ekstreme.
41. Tiran pa kufij.
46. Në hyrje të oazit.
48. Fillojnë ilustrimet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Marple a Agatha Christie.
4. Zanore për zulu.
6. Qyteti i Protogora-s.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Janë tek në kufij.
14. Benigni aktor.
16. Mund të jetë me mbret.
18. Gjysmë ndikim.
20. Një dru aromatik.
21. Teqe trani.
23. Janë me numër të tilla ushtarake.
24. Nusja pa çifte.
25. Iglit te Lazio.
26. Një pjesë e sipërfaqes.
27. Një fjalë... para kohe
28. Janë mashtrime... me grim.
31. Duken të gjata në pritje.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Shkruehen për filma.
5. Janë malet ruse të tilla
6. Agjenci Botuese Lokale.
7. Një kontestues i viteve shatërdhjetë.
8. Në krye të drejtuesve.
9. Eshhtë racë kombi.
10. Steiger aktor.
13. I vihen kalit.
15. Një britmë në corrida.
16. Një gjellë gratis.
17. Rolet pa zë.
19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
20. Një brejtës pylli.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për gol.
27. Janë maskarenj.
28. Tre në tetëdhjetë.
29. Emri i parë i Fassbinder.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë Organoziata e skuadrave të Formula 1.
35. Mbyllin punimet.
37. Ndodh në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Pak tradicionale.
41. Një cigan.
43. Fillojnë lehtë.
45. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 9 | | 1 | 5 | | | | |
| 6 | | | | 7 | | | | |
| 5 | | | | | | | | 3 |
| | | | 9 | | | | 3 | 8 |
| | | | 9 | | | | | 1 |
| | | | 3 | | 8 | 5 | 7 | |
| | 6 | | | | 9 | | | |
| | | | | | | | 4 | |
| 4 | | 2 | | 3 | 7 | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 8 | 6 | 4 | 3 | 9 | 1 | 5 | 2 |
| 9 | 2 | 4 | 1 | 6 | 5 | 8 | 3 | 7 |
| 5 | 3 | 1 | 2 | 7 | 8 | 4 | 9 | 6 |
| 1 | 4 | 2 | 3 | 5 | 7 | 9 | 6 | 8 |
| 8 | 9 | 5 | 6 | 1 | 2 | 3 | 7 | 4 |
| 3 | 6 | 7 | 9 | 8 | 4 | 2 | 1 | 5 |
| 2 | 7 | 9 | 5 | 4 | 3 | 6 | 8 | 1 |
| 4 | 1 | 8 | 7 | 9 | 6 | 5 | 2 | 3 |
| 6 | 5 | 3 | 8 | 2 | 1 | 7 | 4 | 9 |

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---|----|
| 6 | 4 | 19 | 5 | 6 | 4 | 6 | 6 | 1 | 4 | 1 | 7 |
| 1 | 15 | | 11 | 8 | 8 | 6 | 5 | L | M | I | A |
| 17 | | 14 | 8 | 5 | 8 | 12 | 1 | 7 | 8 | 7 | 5 |
| 6 | 3 | 7 | 9 | 6 | 1 | 13 | 8 | 7 | 14 | 8 | |
| 17 | 9 | 6 | 19 | 13 | 3 | 7 | 3 | 7 | 3 | 7 | 13 |
| 9 | 16 | 8 | 15 | 1 | 7 | 9 | 15 | 8 | 7 | 7 | 7 |
| | | 13 | 3 | 8 | 13 | 9 | | 12 | 1 | 1 | |
| 16 | 4 | 13 | | 13 | 3 | 6 | 1 | 5 | 5 | 3 | |
| 1 | 6 | 3 | 1 | 13 | 7 | | 17 | | 9 | 4 | 8 |
| 13 | | 9 | 7 | 8 | 17 | 3 | 16 | 9 | 15 | 8 | |
| 3 | 7 | 13 | 8 | 7 | 3 | 5 | 2 | 13 | 3 | 8 | |
| 17 | 15 | 3 | 6 | 3 | | 4 | 3 | 15 | 7 | 1 | 17 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | R | S | E | R | I | K | O | D | A | K | |
| T | A | T | A | M | I | S | | R | R | I | |
| I | I | H | I | P | O | T | E | Z | A | T | |
| N | P | A | R | A | K | A | L | I | M | E | T |
| A | N | E | T | A | R | E | T | L | A | A | |
| R | R | I | T | I | O | I | T | A | | | |
| A | T | E | E | M | R | A | I | R | O | | |
| K | E | N | E | T | E | I | T | A | K | A | |
| T | K | D | | T | A | A | N | T | A | | |
| O | T | I | T | I | G | R | T | K | | | |
| R | U | M | I | S | I | O | N | A | R | E | T |
| E | K | S | T | R | E | M | I | S | T | E | T |

Argëtim filozofik

- Jeta është gjithmonë duke pritur kohën e përshtatshme për veprim.

- Ndonjëherë jeta i ndan dy njerëz vetëm për të treguar se sa të rëndësishëm janë ata për njëri-tjetrin.

- Ajo që ndodh një herë, nuk mund të ndodhë përsëri. Por ajo që ndodh dy herë, patjetër do të ndodhë dhe për së treti.

Thënie të mençura

- Të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.
- Nëse dashuria transformon një person me shpejtësi, dëshpërimi e bën atë edhe më shpejt.
- Sapo kam gjetur të gjitha përgjigjet, menjëherë ndryshuan të gjitha pyetjet.
- Gjithmonë të shprehni atë që ndjeni dhe të bëni atë që mendoni! Heshitja shkatërron jetën...

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| L | A | U | R | A | K | O | H | A | A | P | | |
| V | O | L | T | A | D | O | G | A | N | A | R | |
| A | R | I | E | M | I | M | R | S | E | | | |
| D | H | P | A | K | E | T | I | M | E | T | T | |
| U | H | P | A | K | E | T | I | M | E | T | T | |
| Z | E | M | E | R | K | E | T | N | E | T | E | M |
| F | I | D | N | E | T | N | E | T | E | M | | |
| S | E | N | A | T | I | I | B | E | R | I | K | E |
| S | E | N | E | K | A | L | L | A | P | A | T | |
| T | R | E | E | L | S | A | T | T | | | | |
| L | I | V | E | T | A | K | A | A | D | | | |
| N | A | A | R | N | J | E | A | P | E | L | | |

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

